



INTERVISTA



“Ushtarakët më kanë pritur në mënyrën më pozitive të mundshme”

Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli, pas vizitës së kryer në Greqi, shprehet optimiste për zgjidhjen qoftë të çështjes së toponimeve, ashtu edhe atë detare. Në “Tonight, Ilva Tare”...

faqe 4

DEMONTIMI

Ministrja Kodheli inspektoi Kombinatin Mekanik të Poliçanit

Kërkohe siguri absolute për punonjësit dhe komunitetin, si dhe të minimizohet ndotja e ambientit

faqe 2

BASHKËPUNIMI

SHSHP të FA, takim me atasheun ushtarak të Gjermanisë

faqe 2

VLERËSIMI



Ministrja Kodheli dekoron atasheun ushtarak amerikan

Dekorohe kapiten i rangut të II-të Glenn Brown me rastin e përfundimit të misionit të tij në këtë detyrë. Gjithashtu, në këtë ceremoni është prezantuar edhe atasheu i ri amerikan në Tiranë, kapiteni i rangut të II-të Ralph Shield

faqe 2

MINISTRJA KODHELI INSPEKTON KOMANDËN E FD DHE QNOD

Prezantohet drejtori i ri i QNOD, gjeneralmajor (r) Maksim Malaj

Znj. Kodheli u ndal sidomos në luftën që duhet bërë për parandalimin e abuzimeve dhe keq-menaxhimit që janë vërejtur edhe në strukturat e Forcave Detare. Në këtë kontekst, ajo dha porosi të qarta për rivlerësimin e aseteve që disponon kjo Forcë...



faqe 2

TAKIMI I 170-të I SHEFAVE TË MBROJTJES SË NATO-s

Përcaktohen prioritetet ushtarake për 2014-ën

Komiteti Ushtarak, autoriteti më i lartë ushtarak i NATO-s, u mbledh më 22-23 janar në selinë e NATO-s në Bruksel për sesionin e parë të shefave të Mbrojtjes për vitin 2014. Në këtë takim mori pjesë edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Jeronim Bazo

faqe 3



SPECIALE

Patricie Nugee, - Edit Durhami i shekullit të XXI-të, “certifikohet” nga FA



Nga komandant/rektor i AFA, kol. Prof. Asoc. Dr. Agim Sula, zonjës Patricie Nugee ju dha Certifikatë Mirënjohje me motivacion: “Për kontribut të dhënë në mbledhjen dhe pasurimin e librave të rrallë për Skënderbeun, në gjuhë të huaj kudo në botë”

faqe 8-9

EMËRIMI

Gjeneralbrigade Piro Ahmetaj, këshilltar i Mbrojtjes së Presidentit

faqe 6

CEREMONIA

Certifikohen 32 ushtarakë të FT për kursin funksional “Komando”


faqe 10

MAT 4

“Striking Eagles 4”, fundi i një etape dhe nisja e një rruge të re

faqe 12

DOSSIER



Shqipëria e Luftës së Ftohtë, në dokumentet Sekrete të NATO-s

Kohët e fundit, NATO ka de-klasifikuar disa prej dokumenteve Sekrete të Aleancës, të cilat i përkasin periudhës së Luftës së Ftohtë. Në to jepen detaje e të dhëna për Bllokun Lindor dhe Perëndimor në përgjithësi dhe për shtete apo grup-shtetesh të ndryshme...

faqe 7

Ministrja Kodheli dekoron atasheun ushtarak amerikan

Prezantohet atasheu i ri amerikan në Tiranë, kapiteni i rangut të II-të Ralph Shield

Në Ministrinë e Mbrojtjes u organizua pasditen e datës 20 janar 2014, ceremonia e dekorimit të atasheut ushtarak të SHBA, të akredituar në vendin tonë, kapiteni i rangut të II-të Glenn Brown me rastin e përfundimit të misionit të tij në këtë detyrë. Gjithashtu, në këtë ceremoni është prezantuar edhe atasheu i ri amerikan në Tiranë, kapiteni i rangut të II-të Ralph Shield. Në ceremoni ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ambasadori i SHBA në Tiranë, Alexander Arvizu, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të MM dhe Shtabit të Përgjithshëm, përfaqësues të zyrës së CUBIC, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë etj. Duke marrë fjalën në këtë ceremoni, ministrja e Mbrojtjes, znj. Kodheli theksoi se është një kënaqësi e veçantë për të gjithë ne që marrim pjesë në këtë ceremoni me rastin e dekorimit të kapitenit të rangut të II-të Glenn Brown, i cili për tre vjet rresht ka shërbyer si atashe ushtarak i SHBA në vendin tonë. Zonja Kodheli ka falënderuar ushtarakun e lartë amerikan për kontributin që ai ka dhënë për Forcat e Armatosura shqiptare, si dhe familjen e tij për mbështetjen që ajo ka dhënë për kryerjen me sukses të detyrës së tij si atashe ushtarak në Tiranë. Në fund të fjalës së saj, ministrja Kodheli i ka uruar kapitenit të rangut të II-të Brown suksese në detyrën e tij të re. Gjithashtu ajo i uroi mirëseardhjen në Tiranë atasheut të ri ushtarak të SHBA, kapitenit të rangut të II-të Ralph Shield. Në ceremoni përshëndeti edhe ambasadori i SHBA në Tiranë, Alexander Arvizu. Më pas, ministrja Kodheli i dorëzoi kapitenit të rangut të II-të Glenn Brown medaljen "Për Shërbime të Shquara". Me këtë rast, kapiteni i rangut të II-të Brown falënderoi ministren e Mbrojtjes Kodheli për vlerësimin e lartë që i bëri punës dhe kontributit të tij, si dhe bëri vlerësime mjaft pozitive për bashkëpunëtorët e tij dhe ushtarakët shqiptarë me të cilët ka bashkëpunuar përgjatë këtyre tre viteve për realizimin me përkushtim të detyrave në interes të forcimit të FA shqiptare.



Ministrja e Mbrojtjes Kodheli inspektoi Kombinatin Mekanik të Poliçanit

Ministrja Kodheli: Kombinati i Poliçanit e vetmja mundësi punësimi për banorët e zonës. Kërkohej siguri absolute për punonjësit dhe komunitetin, si dhe të minimizohet ndotja e ambientit

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, ka zhvilluar në datën 20 janar 2014, një inspektion në Kombinatin Ushtarak Mekanik të Poliçanit. Ministrja Kodheli u prit nga kryetari i Bashkisë së Poliçanit, z. Adriatik Zotka dhe nga drejtori i Kombinatit, Altin Lamçe. Fillimisht, ministrja Kodheli është takuar me stafin drejtues të Kombinatit të Poliçanit, nga ku drejtori Lamçe e informoi mbi veprimtarinë e këtij Kombinatit,

rezultatet e arritura në procesin e demontimit të municioneve, si dhe me kushtet e punës dhe problematikat që ka aktualisht në këtë ndërmarrje ushtarake. Ministrja Kodheli u shpreh se Kombinati i Poliçanit është i vetmi burim punësimi për zonën. Ajo kërkoi në mënyrë të veçantë sigurinë e punonjësve dhe sigurinë e të gjithë komunitetit gjatë proceseve që kryhen në këtë uzinë. Po kështu, ministrja Kodheli la mjaft detyra konkrete jo vetëm për vijimin

e procesit të demontimit, por edhe për përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit e tij. Gjithashtu, znj. Kodheli kërkoi një raport të detajuar mbi masat që duhen marrë për të ulur ndotjen e mjedisit. Më pas, ministrja Kodheli ka vizituar nga afër disa nga repartet e Kombinatit të Poliçanit dhe është takuar me punonjës të tij. Po sot, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli ka inspektuar edhe Batalionin e Tretë të Forcave Tokësore në Poshnje të Beratit.

Ministrja Kodheli inspekton Komandën e Forcës Detare dhe QNOD

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, paraditen e datës 21 janar, bëri një vizitë në Komandën e Forcës Detare në Durrës. Pas takimit që pati me komandantin e kësaj Force, gjeneralbrigade Qemal Shkurti, ministrja Kodheli nëpërmjet një brifingu u njoh me detyrat që kryejnë Forcat Detare, rezultatet e arritura në procesin e zbatimit të tyre, si dhe me problemet dhe kërkesat që ata kanë për rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të misionit të tyre kushtetues. Ministrja Kodheli, duke marrë fjalën në takim me drejtuesit dhe personelin e shtabit të kësaj Komande, vlerësoi punën dhe përpjekjet që ata kanë bërë për zbatimin e detyrave funksionale dhe për arritjet e shënuara gjatë vitit që shkoi. Znj. Kodheli u ndal sidomos në luftën që duhet bërë për parandalimin e abuzimeve dhe keq-menaxhimit që janë vërejtur edhe në strukturat e Forcave Detare.



Në këtë kontekst, ajo dha porosi të qarta për rivlerësimin e aseteve që disponon kjo Forcë, duke kërkuar njëkohësisht që të bëhen edhe propozime konkrete në mënyrë që të jemi efikas në nivelin qind për qind, ka theksuar min-

SHSHP të FA, takim me atasheun ushtarak të Gjermanisë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të SFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ka pritur në një takim kortezie atasheun ushtarak gjerman, nënkolonel Guido Altendorf. Nënkolonel Altendorf i ka uruar gjeneral Bazos suksese për detyrën madhore të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH. SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka vlerësuar nivelin aktual të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona në fushën e mbrojtjes, për arritjen e rezultateve të mira në zhvillimin e përbashkët të koncepteve të arsimit ushtarak, zhvillimin e planeve dhe programeve mësimore të akademive, përgatitjen dhe kualifikimin e pedagogëve shqiptarë, për vënien e arsimit tonë ushtarak mbi baza shkencore e bashkëkohore dhe në përputhje me standardet përëndimore si dhe bashkëpunimi në fushën e mjekësisë. Gjeneral Bazo ka theksuar në këtë takim se Shqipëria e sheh me shumë interes bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes me Gjermaninë si partnerë të barabartë dhe anëtarë të së njëjtës Aleancë, duke qenë se Forcat tona të Armatosura kanë marrë mjaft eksperiencë për të shërbyer si të barabartë në misionin tonë të përbashkët të ruajtjes së paqes dhe sigurisë në vendet tona dhe më gjerë. Shembull i kësaj rritjeje profesionale është edhe bashkëpunimi me forcat gjermane dhe të vendeve të tjera aleate, në SFOR (sot misioni ALTHEA) si dhe në Afganistan. Nënkolonel Guido Altendorf pasi e ka falënderuar gjeneral Bazon për pritjen e rezervuar ka rikonfirmuar thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy vendeve tona.

Zhvillohet në Bruksel takimi i 170 i shefave të Mbrojtjes së NATO-s

Komiteti Ushtarak, autoriteti më i lartë ushtarak i NATO-s, u mbledh më 22-23 janar në selinë e NATO-s në Bruksel për sesionin e parë të shefave të Mbrojtjes për vitin 2014. Në këtë takim mori pjesë edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm së FA të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Gjenerali Knud Bartels, kryetar i Komitetit Ushtarak, kryesoi një seri takimesh me aleatët e partnerët e NATO-s lidhur me operacionet aktuale të NATO-s, aktivitetet e vazhdueshme të transformimit si dhe forcimin e partneriteteve të ardhshme.

Takimi i 170 i shefave të Mbrojtjes së NATO-s filloi më 22 janar me sesionet e partnerëve nga Dialogu i Mesdheut (MD) dhe Këshillin e Partneritetit Euroatlantik (EAPC) se si të zhvillohet më tej bashkëpunimi praktik. Në mesin e folësve kryesorë ishte gjenerali Mashal al Zaben, kryetar i shefave të Shtabit të Bashkuar të Forcave të Armatosura jordaneze, i cili ofroi pikëpamjet e tij rreth situatës aktuale të sigurisë në rajonin e MD. Gjenerali i ushtrisë, Valery Gerasimov, shefi i Shtabit të Përgjithshëm së Forcave të Armatosura së Federatës Ruse, priti Këshillin NATO-Rusi, me përfaqësuesit ushtarakë (NRC-MR), duke ndarë pikëpamjet e tij për bashkëpunimin ushtarak. Shefat e Mbrojtjes miratuan Planin e Punës 2014 NRC-MR, i cili do të fillojë aktivitetet e këtij viti.

Më pas, shefat e Mbrojtjes së NATO-s dhe partnerët shqyrtuan operacionin aktual në Afganistan si dhe diskutuan planet për misionin e ardhshëm, Rolute Support (Mbështetje e Vendosur). Diskutimeve do t'i bashkohen dhe më të reja e situatës nga ambasadori Maurits Jochems, përfaqësuesi më i lartë civil i NATO-s në vend, gjenerali Philip M. Breedlove, komandanti Suprem i Aleatëve në Europë dhe gjenerali Joseph F. Dunford, komandant i operacioneve të ISAF-it. Në takimin me partnerët e KFOR-it, shefave të Mbrojtjes ju paraqit një pasqyrë politike dhe operacionale rreth situatës së sigurisë në Kosovë, e cila do të formojë një bazë për diskutime rreth prezencës së ardhshme së NATO-s në Kosovë.

Takimi i 23 janarit u fokusua në transformimin e NATO-s dhe në veçanti në aktivitetet që mbështesin shpërndarjen e gatshme, të përshtatshme dhe efektive të aftësive ushtarake të NATO-s. Gjenerali Jean-Paul Palomeros, komandanti Suprem i Forcave Aleate dhe Transformimit, ofroi mendimet e tij rreth stërvitjes "Trident Juncture 2015", një stërvitje në shkallë të madhe, e cila do të zhvillohet në vitin 2015 dhe që do të theksojë fokusin e NATO-s në gatishmërinë operacionale dhe aspekte më të gjera lidhur me Iniciativën e Forcave të Ndërlidhura. Më pas, gjenerali Patrick Rousiers, kryetar i Komitetit Ushtarak të Bash-



Foto: SHSHP FARSH gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe SHSHP të Hungarisë gjeneral Tibor Benko

kimit European, bëri një prezantim mbi rezultatin dhe zbatimin që pason samitin e fundit të Mbrojtjes së

Bashkimit European, i cili përfundoi debatet rreth Mbrojtjes së Zgjuar. Qëllimi gjatë dy-ditëve ishte analiz-

imi i shpërndarjes ushtarake kyçe për serinë e ardhshme të takimeve ministeriale të NATO-s dhe samitit

të mëvonshëm të NATO-s, i cili do të mbahet në Uells, në muajin shtator të këtij viti.

Knud Bartels: Viti 2014 duhet të jetë viti që ne shpërndajmë progres të dukshëm në transformimin e NATO-s

Në takimet tona të mëparshme, kemi qenë të vetëdijshëm se procesi i tranzicionit nga operacione në gatishmëri, kërkon kohë dhe investime, të cilat janë burime të rëndësishme dhe të pakta. Viti 2014 duhet të jetë viti që ne shpërndajmë progres të dukshëm në transformimin e NATO-s, në mënyrë që të vendosim kushtet për Forcat e NATO-s 2020: Moderne, të lidhura ngushtë, të pajisura mirë, të trajnuara, të stërvitura e të komanduara në mënyrë që të veprojnë së bashku dhe me partnerët në çdo mjedis. Samiti i Uellsit i vitit 2014 dhe seria e takimeve ministore të NATO-s që do të paraprijnë këtë samit, do të jenë katalizatorë të rëndësishëm që do ta çojnë përpara procesin e transformimit të NATO-s. Roli i këtij komiteti për të mundësuar këto takime vendimtare do t'i sigurojë me kalimin e kohës, kështu që e mirëpres pjesëmarrjen tuaj aktive në takimet tona dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme për mbrojtjen dhe NATO-n në kapitalet tuaja. Ky takim, i jep mjaft rëndësi një viti të tillë sfidues dhe po parashtrij tre parimet e diskutimeve tona: Së pari, duhet të vazhdojmë të kemi sukses në operacionet tona aktuale në Afganistan, Kosovë dhe në misionet detare të NATO-s, duke pasur parasysh kërcënimin aktual, tani nuk është koha për mungesë vendosmërie. Së dyti, duhet të vazhdojmë të drejtojmë zbatimin praktik të Transformimit të NATO-s për të siguruar që Aleanca ka Struktura Komande efektive dhe të gatshme si dhe forca për t'u përballur me sfidat e së ardhmes. Këtë vit, në veçanti, duhet të fokusohemi në edukimin, trajnimin, stërvitjen, vlerësimin si dhe në shpërndarjen e aftësive kryesore nëpërmjet Procesit të Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s. Suksesi ynë në këtë përpjekje është një parakusht për të ruajtur forcën ushtarake dhe kredibilitetin e Aleançës. Së fundmi, duhet të ndërtojmë mbi partneritetet që kemi vendosur gjatë operacioneve, për të ruajtur bashkëpunimin, ndikimin dhe interesin me ato vende që vazhdojnë të kërkojnë një marrëdhënie strategjike dhe operacionale me NATO-n. Në këtë pikë, do të doja të theksoja e të falënderoja pjesëmarrjen e fundit të Zelandës së Re në misionin e NATO-s kundër piraterisë në Oqeanin Indian, Operacioni "Ocean Shield" (Mburoja Oqeanike), me fregatën HMNZS TE MANA për tre javë, duke filluar nga 23 janari, si një shembull aktiviteti reciprokisht të dobishëm partneriteti, që Aleanca do të inkurajojë. Në këtë takim tonin, fokusi mbetet kryesisht në aktivitetet me partnerët tanë. Shumë prej Kombeve të Dialogut Mesdhetar vazhdojnë të japin një kontribut të madh në operacionet e udhëhequra nga NATO si dhe marrin pjesë në aktivitete të rëndësishme të partneritetit të NATO-s. Duke pasur parasysh turbullirat e rajonit lidhur me Dialogun Mesdhetar dhe



afërsinë e tij me kufijtë e NATO-s, ky forum është mjaft i rëndësishëm për Aleançën. Prandaj, në këtë takim të dhjetë tonin në nivel të shefave të Mbrojtjes me partnerët tanë të Dialogut Mesdhetar, ne do të shqyrtojmë se si NATO mund të forcojë marrëdhëniet e rëndësishme që ka në këtë rajon në të mirë të Aleançës dhe partnerëve tanë me vlerë. Më pas, në takimin me partnerët tanë të operacioneve aktuale të ISAF-it në Afganistan, do të informohemi nga SACEUR, përfaqësuesi i Lartë

Civil i NATO-s në Afganistan dhe komandanti i ISAF-it. 11 muajt e fundit të operacionit të ISAF-it, NATO mbetet e angazhuar në zhvillimin e Forcës së Sigurisë Kombëtare Afgane. Ne do të fokusohemi në përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme presidenciale afgane. Në takimin për diskutimin e misionit "Resolute Support 2014" (Mbështetje e Vendosur 2014) në Afganistan, me ne do të bashkohen dhe përfaqësues nga dhjetë vende partnere, të cilët janë angazhuar në mbështetjen e këtij misioni. Aktualisht, NATO po punon me autoritetet afgane për të vendosur kuadrin ligjor të misionit "Resolute Support" dhe do të vazhdojmë të zhvillojmë planet tona, në mënyrë që të jemi të gatshëm kur këto të kërkojnë. Ne do të vazhdojmë planifikimin dhe përgatitjet për misionin e trajnimit, këshillimit dhe ndihmës pas vitit 2014, për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të forcave të besueshme, të afta e të qëndrueshme të sigurisë afgane. Në takimin e Partneritetit Atlantik European, ne do të informohemi nga SAUCER në zonat e bashkëpunimit ushtarak me partnerët dhe nga kreu i Komandës Strategjike të Divizionit të Bashkëpunimit Ushtarak në strukturat e reja të bashkëpunimit ushtarak. Në Këshillin NATO-Rusi, në formatin e shefave të Mbrojtjes së Komitetit Ushtarak, me ne do të bashkohet gjenerali Gerasimov, shefi i Shtabit të Përgjithshëm së Federatës Ruse. Në këtë mbledhje, ne do të vazhdojmë dialogun konstruktiv mbi aktivitetet e partneritetit që promovojnë besim dhe mirëkuptim të ndërsjellë. Prandaj, ne do të kërkojmë një marrëveshje rreth një Plani Pune për bashkëpunim në vitin 2014 dhe do të konsiderojmë disa shembuj praktikë bashkëpunimi ndërmjet NATO-s e Rusisë përmes Iniciativës së Bashkëpunimit të Hapësirës Ajrore dhe zbatimin e Fondit të Besimit të Helikopterëve Afganë. Më pas, do të zhvillohet takimi me partnerët tanë operacionale të KFOR-it ku do të diskutojmë situatën politike dhe operacionale pas zgjedhjeve të fundit bashkiake në Kosovë. Gjithashtu, shpresojmë të miratojmë një seri standardesh dhe treguesish për kushtet e sigurisë që do të informojnë çdo vendimmarrje të mëtejshme rreth formës së ardhshme të prezencës së NATO-s në Kosovë".

Alba Musaraj

Kodheli flet për sfidat me të cilat përballet Ushtria shqiptare dhe Ministria që ajo drejton

“Ushtarakët më kanë pritur në mënyrën më pozitive të mundshme”

Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli, pas vizitës së kryer në Greqi, shprehet optimiste për zgjidhjen qoftë të çështjes së toponimeve, ashtu edhe atë detare. Në “Tonight, Ilva Tare”, Kodheli foli për sfidat me të cilat përballet ushtria shqiptare dhe Ministria që ajo drejton

Zonë e vështirë Lezha, nga ku dolët deputete?

Lezha është një qark i vështirë, por jo i pamundur. Njerëz të hapur, por dhe zona të vështira për shkak të varfërisë, për shkak të mentalitetit. Të rinj të zotë, por i kam gjetur të pashpresë përpara qershorit dhe sigurisht shpresoj shumë të ndryshojnë mjaft gjëra në këtë qark, sepse qarku realisht e meriton. Ka shumë shpresë që e ardhmja e qarkut të Lezhës ashtu si e ardhmja e gjithë Shqipërisë të jetë e të rinjve, një gjenerate tjetër.

Si e pritët marrjen e detyrës në krye të MM?

Ishte emocionuese, intriguese, por edhe sfidë e madhe. Besoj që ishte një zgjedhje jo e zakonshme. Siç e thatë dhe ju, dominim mashkullor, jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj. Ishte një sfidë për mua, por dhe sigurisht një shenjë besimi dhe respekti ndaj asaj që unë përfaqësoj, asaj që unë kam bërë dhe gjërat me të cilat jam marrë.

Po ushtarakët si e pritën?

Absolutisht në mënyrën më pozitive të mundshme, siç mendoj se nuk kanë pritur asnjë ministër paraardhës. Duket sikur kjo që them është diçka e ekzagjeruar, në fakt unë ndihem komode me ta dhe pa më të voglin dyshim ata ndihen komod me mua.

Sapo jeni kthyer nga Greqia në një vizitë të nivelit të lartë ku keni takuar krerët kryesorë të shtetit helen dhe u diskutuan ato



që kemi shqetësime kryesore. Pra, më lejoni t'ju pyes pse i ngre pala greke çështje si toponimet, ligjin e luftës apo çështjet e varrezave ministrit të Mbrojtjes?

Vizita ime ishte në përgjigje pozitive të ftesës së homologut Avramopulos. Pra, ishte një vizitë e mirëfilltë e një ministri Mbrojtjeje të një vendi të NATO-s tek një ministër i Mbrojtjes së një vendi të NATO-s. Besoj që shpeshherë në media nxirren disa elemente të diskutimeve, të cilat bëjnë më shumë lajm, por mund t'ju them se pjesa më e madhe e diskutimeve dhe pjesa më e rëndësishme e takimeve të mia atje kishin të bënin në mënyrë të mirëfilltë me probleme me të cilat dy Ministrinë tona ndajnë, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe ajo Kombëtare Greke.

Cilat janë këto probleme?

Problemet dalin nga situata gjeopolitike me të cilat përballet bota dhe rajoni, probleme të sigurisë, probleme të mbrojtjes, që besoj se

në ditët tona, por edhe në ditët në vazhdim do të jenë në top listën e problemeve që një vend ka.

Cilat janë problemet gjeopolitike në të cilat Shqipëria mund të ketë një rol?

Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s dhe si i tillë ka një rol shumë të rëndësishëm duke filluar që nga siguria e asaj çka Ministria jonë e Mbrojtjes dhe Forcat tona të Armatosura kanë për detyrë të mbajnë që është një detyrim kushtetues dhe ligjor, rajonin dhe shumë më gjerë. Shqipëria merr pjesë në misionet paqeruajtëse, Shqipëria lufton në front të parë në Afganistan, Shqipëria është prezent në KFOR, Shqipëria është prezent në misionin ALTEA.

Po në bashkëpunim me Greqinë, ka diçka të përbashkët që po diskutoni, që po negocioni?

Sigurisht që po, ka shumë gjëra të përbashkëta. Më lejoni ta filloj me trajnimet. Shqipëria ka 35 studentë të rinj apo në karrierë ushtarake që studiojnë në akademitë ushtarake të Greqisë, Selanik dhe Athinë kryesisht, por ka pritur dhe dy oficerë grekë me një karrierë të konsiderueshme le të themi, janë diplomuar në Akademinë e Sigurisë dhe të Mbrojtjes në Tiranë. Pra, ka një bashkëpunim mjaft intensiv lidhur me trajnimet, ka një bashkëpunim me stërvitjet e përbashkëta, ka bashkëpunim në shkëmbimin e informacionit. Greqia së bashku me Italinë bëjnë policimin ajror të Shqipërisë, pra mbrojnë Shqipërinë nga ajri dhe ka bashkëpunim në të gjitha fushat ku Ministria e Mbrojtjes ka detyrimin e vet ligjor që të jetë prezente apo të jetë aktori kryesor.

Bisedimet, negociatat e dialogu që patët ishin të mirë në drejtim të

këtyre bisedimeve?

Sigurisht, patjetër, pa as më të voglin dyshim. Ky ishte fokusi kryesor, qëllimi kryesor i vizitës.

Në lidhje me shqetësimin e qytetarëve shqiptarë, të emigrantëve që jetojnë atje, konkretisht për toponimet. Çfarë ju ngriti, çfarë shqetësimi kishte pala greke?

Më lejoni t'ju them se takimi im i parë ishte me kryeministrin Samaras, një takim që nuk i jepet, nuk i akomodohet çdo ministri, por në opinionin e tyre dhe është e drejtë të jetë kështu ministri i Mbrojtjes së një vendi të NATO-s është gjithmonë një ministër Mbrojtjeje i një vendi të NATO-s, aq më tepër kur ky është një vend fqinj, siç janë Shqipëria dhe Greqia. Për fatin tonë të mirë Greqia është në krye të Presidencës së BE dhe unë kërkova nga kryeministri Samaras mbështetjen për marrjen e statusit kandidat në mesin e këtij viti. Kjo ishte le të themi pjesa më e madhe e diskutimit më kryeministrin. Nuk u diskutuan çështjet e toponimeve. Sigurisht që çështjen e toponimeve e ngrita qoftë në bisedimet me homologun, qoftë në bisedimet me presidentin Papulias. Ky është një problem që shqetëson emigrantët shqiptarë në Greqi, është një problem që vështirëson lëvizjet e tyre dhe mendoj që shumë shpejt do të marrë zgjidhje. Ka një komision të ri-formatuar që do ullet të draftojë marrëveshjen, e cila besoj do ta çojë një hap më tutje përfundimin e bisedimeve lidhur me dakortësinë e kësaj çështjeje dhe emigrantët shqiptarë duhet të jenë të qetë, të vazhdojnë të jetojnë e të punojnë dhe i siguroj që qeveria shqiptare do bëjë gjithçka dhe të pamundurën që atyre t'u mundësohet jo vetëm

një qëndrim i qetë atje, por dhe një lëvizje e qetë siç u takon si qytetarë të lirë që janë.

Ka një afat kur mund të ndodhë kjo?

Në fillim të shkurtit, ministri Bushati do të udhëtojë drejt Greqisë dhe mendoj se shumë shpejt do të kemi një rezultat të këtij udhëtimi.

Dua të ndalem tek një tjetër shqetësim, tek marrëveshja e detit.

A u hap në bisedimet tuaja?

U përmend dhe çështja e detit, ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, por sigurisht ka dhe të drejtën ndërkom-bëtare të shkruar e zeza mbi të bardhë, ka ligje të mira greke siç ka ligje të mira shqiptare, të dy vendeve që po përjetojnë demokracinë dhe që padyshim kanë të gjithë mekanizmat për t'i dhënë zgjidhje dhe kësaj çështjeje. Hapat cilësorë janë ata që duhet ta çojnë këtë marrëdhënie në një produkt të prekshëm. Kjo s'do të jetë pengesë që Shqipëria të fokusohet në problemet që ka sot, kryesisht marrja e statusit së vendit kandidat, ku Greqia do jetë aty në mbështetje të Shqipërisë në këtë rrugë.

A është qeveria shqiptare inferiore ndaj palës greke kur negocion, kur diskuton, kur ngre kërkesa?

Unë nuk e kam ndjerë këtë në asnjë moment të vizitës time.

Varrezat greke, çfarë duan autoritetet greke?

Ata duan që të identifikohen ushtarët e rënë në luftërat e shekullit së kaluar, në tokën shqiptare, pjesë e historisë, por pa dyshim e drejtë e çdo shteti për të identifikuar varret e ushtarëve të rënë, në cilindo skalion të luftës që mund të kenë qenë. Ka një komision, i cili po ri-formatohet. Po punohet fort në këtë drejtim dhe është një nga çështjet që do marrë shpejt zgjidhje.

A do të lejojë shteti shqiptar ngritjen e katër mauzoleumeve që kërkon pala greke?

Shtetit shqiptar është firmëtar i marrëveshjeve ndërkom-bëtare, i konventave ndërkom-bëtare dhe bazuar në këto dhe përmes tyre do të gjejë rrugën e duhur për të mundësuar një përgjigje pozitive në raport me fqinjin tonë Greqinë në frymën e bashkëpunimit.

Si do sillen grekët me ne në qershor dhe çfarë përgjigje ju dhamë për kërkesën e heqjes së ligjit të luftës?

Ata kanë siguruar për mbështetjen që do t'i japin Shqipërisë për marrjen e statusit së vendit kandidat. Kjo është thënë qartë, drejt dhe pastër prej tyre. Kjo është diçka shumë e rëndësishme për Shqipërinë, që në fakt Shqipëria e ka merituar të paktën në dhjetor. Është një hap i rëndësishëm në historinë tonë moderne.



Greçia dhe Shqipëria janë anëtare të NATO-s, kanë detyrimin historik të bashkëjetojnë, të mirëkuptohen, të punojnë dhe luftojnë në funksion të sigurisë së vendeve të tyre, rajonit e më gjerë.

Me Kosovën çfarë bashkëpunimi keni në fushën e mbrojtjes, ka lobim nga ana e Shqipërisë përta i takon një aderimi të shpejtë e të mundshëm të Kosovës në NATO?

Ka lobim natyrisht. Ka shumë arsye politike dhe gjeopolitike që hyjnë në këtë proces. Shqipëria është mbështetëse me eksperiencën e saj, diplomacinë që ndihmon në këtë drejtim, partnerët tanë SHBA janë mbështetësit më të mëdhenj të këtij procesi, i cili duhet të jetë një proces tejet i kujdesshëm dhe shumë i matur, gjë të cilën Kosova po e bën me shumë sukses.

Ka një parashikim, një pritshmëri se kur mund të bëhet Kosova anëtare e NATO-s?

Ka disa faza që Kosova duhet të kalojë, më së pari do t'i mundësohet të jetë anëtare me të drejta të plota në disa iniciativa rajonale që do jenë hapat e parë drejt anëtarësimit të Kosovës në NATO, që gjithsesi një ditë ajo do ndodhë.

Rikthyet gjeneralët e shkarkuar? Gjeneralët që ju përmendët në opinionin e gjykatave janë liruar me pa të drejtë. Gjeneralmajor Zaimi dhe Lleshi janë emëruar këshilltarë.

Si i keni marrëdhëniet me komandantin e Forcave të Armatosura? Të shkëlqyera. Gjërat shkojnë institucionalisht ashtu siç duhet të shkojnë.

Pse nuk informuat presidentin Nishani për armët kimike?

Diskutimet kanë qenë më së shumti teknike, konfidenciale. Në punën time të përditshme kam të bëj me dokumente të deklasifikuara. Presidenti informohet, por jo domosdoshmërisht dhe specifikisht për çdo çështje. Do informohej në momentin e duhur.

Çfarë angazhimi u kërkua nga ushtria shqiptare në rast të përgjigjes

pozitive?

Do të kishte një rol të rëndësishëm, sepse do të kryhej në një njësi ushtarake, në një repart ushtarak, i cili padyshim do të sigurohej. Të siguroheshin distancat midis këtij reparti dhe vendeve të banuara, që do të sigurohej dhe nga marinsat që do të vinin për ta shoqëruar këtë si proces.

Do të ishte një operacion i ushtrisë shqiptare dhe i marinsave amerikanë le të themi.

Do të ishte një proces ushtarak le të themi, nuk është një operacion që i takon civilëve. Pjesë e këtyre operacioneve mund të jetë ndonjë ekspert kimie, por dyshoj se ekspertët e kimisë, sidomos të asaj natyre të jenë dhe jashtë radhëve së Forcave të Armatosura të çdo vendi. Duhet të merrnin përsipër sigurinë e vendit ku do të shkatërroheshin.

Pse lejuat atë panik në popull, pse zgjodhët heshtjen?

Ishte moment i vështirë, na u kërkua në bisedime që të ruanim një konfidencialitet të caktuar dhe mendoj se bëmë më të mirën e mundshme deri në fund.

Morëm kosto për jo-në që thamë? Nuk do të marrim kosto.

Do të tregonim që ishim një vend me peshë ndërkombëtare nëse do të thonim po?

Besoje që po. Në këtë rast mendoj se duhet të tregonim siç treguam në mënyrën tonë se Shqipëria mund të jetë dhe ka nderin të jetë pjesë e një operacioni të rëndësishëm që do ta bënte botën dhe aq më shumë rajonin më të sigurt nga çfarë është sot.

Ka ndonjë negociatë që vazhdon ende për ndonjë nga elementët që mund të shkatërrohet në Shqipëri?

Jo, nuk ka.

Dolëm nga harta e interesit së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për këtë operacion.

Jo, nuk mund të them se është çështje harte interesi. Dolëm nga ky operacion dhe besoj se i kemi

dhënë një mesazh partnerëve tanë strategjikë se Shqipëria është një vend që beson tek operacione të kësaj natyre, beson tek lufta e të mirës ndaj së keqes, beson tek munda që shoqëria njerëzore mund të bëjë, madje stërmundimi që duhet të bëjë shoqëria njerëzore për ta bërë më të sigurt të ardhmen e brezave.

Akuzat e ngritura ndaj Imamit, duhet të bëheshin nga ju?

Drejtuuesi i institucionit është përgjegjës për çdo gjë që ndodh në institucion. Rasti ka dalë nga auditimi dhe inspektimi që nuk është bërë në vite në MM. Ka disa sektorë që kanë 8 vjet pa u audituar dhe me ligj e kanë çdo vit dhe kjo ka rritur zullumin. Ne kemi bërë detyrën dhe do vazhdojmë ta bëjmë detyrën në respekt të ligjeve të këtij vendi, në respekt të transparencës, në respekt të luftës ndaj korrupsionit. Është një inflacion i lartë fjala luftë kundër korrupsionit sot në vend dhe megjithëse ka një inflacion të lartë, them se nuk është i mjaftueshëm. Duhet thënë, përsëritur dhe vepruar pafundësisht. Shqipëria duhet të dalë nga harta e vendeve më të korruptuara në botë, përndryshe nuk ka asnjë shans të shkojë në Europë, as të jetë një vend lider në rajon dhe as të mundësojë rritjen e mirëqenies së qytetarëve të saj.

Çfarë ka bërë z. Imami, nuk ka ushtruar detyrën për të audituar vendimet që kanë marrë komisionet?

Kjo është një përgjigje që do ta japi prokuroria bashkë me gjykatat që janë pushtete të pavarura në këtë vend. Gjithsekush duhet të bëjë detyrën e vet, ne bëmë tonën. Unë kam bërë thjesht dhe vetëm detyrën time.

Si e gjykoni deri tani punën e prokurorisë për hetimin e kësaj çështjeje?

Nuk jam unë që e gjykoj detyrën e prokurorisë. Kur të dalin rezultatet atëherë do t'u them si ka punuar

prokuroria për këtë rast. Në momentin që procesi është nën hetim nga ana e prokurorisë, e vetmja gjë që mund të them sot është vetëm se çfarë ka bërë ministria deri në dorëzimin në prokurori të dosjes së këtij rasti.

Sa të rënda janë shkeljet?

Shqipëria që prej vitit 2009 është anëtare e NATO-s, por kjo nuk mjafton. Duhet që ushtria shqiptare të modernizohet dhe kjo s'mund të bëhet vetëm duke shitur pronat pa ditur kujt, ku dhe sa duhej ushtria e shteti shqiptar të përfitonin. Ushtria shqiptare s'mund të quhet e modernizuar vetëm se ka ulur numrin e saj dhe ka nxjerrë njerëz në rezervë. Ushtria ka përfutur disa para me të cilat ajo duhej të modernizohej. Në ushtrinë shqiptare ka një batalion këmbësorie, që quhet Batalioni i Dytë i Këmbësorisë që duhet të pajiset me armatim, pajime, veshje, trajnim, stërvitje e përgatitje fizike, anglisht sipas standardeve të NATO-s dhe nuk është bërë asgjë fare. Disponojmë ca kallashë që janë jashtë çdo standardi NATO e nuk mund të përdoren për asgjë, ndërkohë që vlera për ta bërë këtë gjë është 1/3, 1/4, 1/10 e parave të modernizimit, jo ato të buxhetit, që janë përdorur komplet në një destinacion tjetër. Ne kemi gënjyer përfaqësuesit e NATO-s duke thënë na e shtyni dhe pak modernizimin se s'kemi mundësi monetare për ta bërë këtë gjë. Mundësitë i kemi pasur, por paratë i kemi çuar t'i shpenzojmë për të bërë ndonjë makijazh të qeverisë që iku dhe kjo është shumë e gabuar.

Janë bërë dhe blerje prej 78.7 milionë euro për pesë helikopterë COUGAR që u blenë nga Franca.

Po sigurisht, por që të vijnë në nivelin e të qenit helikopterë që duhet të marrin pjesë në luftime duhet akoma kohë, sepse duhet të trajnojmë pilotët, paratë e të cilëve nuk janë paguar. I kemi trajnuar, por kemi 2 milionë euro borxh të papaguara akoma për trajnimin e pilotëve.

Po helikopterët i kemi marrë të

gjithë?

Jo, nuk i kemi marrë të gjithë. **Sa helikopterë mungojnë ende dhe çfarë do të bëhet me helikopterin që u rrëzua në Francë teksa po provohej?**

Në vend të tij do kërkojmë tjetër. Do ta përdorim këtë mundësi që na u dha për shkak të një fatkeqësie për të sjellë disa helikopterë që realisht do të na hyjnë në punë në kërkimshpëtim, në transport mjekësor e kështu me radhë dhe siç kemi bërë trajnimin e pilotëve, kemi dhe ca milionë borxhe të tjerë që datojnë nga viti 2008 dhe borxhet janë rreth 10% të buxhetit total që Ministria e Mbrojtjes percepton. Pra, ne tani duhet të dalim në nivelin zero, të paguajmë 15 milionë euro borxhe të prapambetura dhe pastaj të fillojmë ndonjë punë për modernizimin e ushtrisë. Ju siguroj që këtë radhë nuk do të jetë si vitet e kaluara, do të shkojnë me të vërtetë për modernizimin real të ushtrisë shqiptare, sepse është detyrim kushtetues, detyrim NATO dhe pse është përgjigja më e mirë që mund t'i jepet të gjithë atyre ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve që derdhin mund dhe djersë përditë në atë që quhet Forca të Armatosura të Shqipërisë.

Një prej helikopterëve duhet të ishte dhe i emergjencës, që do të kishte brenda dhe pajisjet e ndërhyrjes së shpejtë. A kanë ardhur të tillë?

Po, kanë ardhur.

Imamin e keni akuzuar në fund vetëm për dhënie reklamash të një televizionit?

Rezultatet e inspektimit dhe auditimit në Ministrinë e Mbrojtjes vetëm sa kanë filluar.

Do të ketë kallëzime të tjera nga ministria juaj për zyrtarë të tjerë?

Varet nga rezultatet që do të dalin nga auditimet.

Çfarë do të bëhet me SHIU-n?

Shërbimi sot quhet AIM, nuk quhet më SHIU. Do jetë një shërbim në ristrukturim, në nevojë për t'u transformuar e perfeksionuar, për të ndryshuar bazën ligjore dhe për t'u vënë realisht në shërbim të Forcave tona të Armatosura dhe jo të pushtetit.

Më lejoni të ndalem pak tek MEICO, çfarë po ndodh me demontimin, ka kontrata?

Të gjitha agjencitë e MM duhet të kalojnë në një skanim jo domosdoshmërisht radikal, por të bëhet një analizë e drejtë në funksion të të ardhurave të ministrisë, shtetit, por në mënyrë të veçantë në funksion të largimit të atyre lëndëve. Ne kemi tre ndërmarje që demontojnë, të cilat janë të specializuara të merren me demontimin e armëve, proces që ka mbërritur pothuajse në fund të trajektoreve të tij. Demontimi s'ka lidhje me kontraktimin, ne shpërbëjmë të gjitha materialet e rrezikshme dhe të panevojshme që trashëguam.

Pritet reformë në ushtri?

Jemi duke punuar intensivisht. Nga 10.000 që janë sot duhet të shkojnë në 8.850 në fund të 2015.

Do kërkoni pronat, SHQUP-in p.sh? Ne do bëjmë një analizë të plotë, më pas do vendosim.



Gjeneralbrigade Piro Ahmetaj, emërohet këshilltar i Mbrojtjes së Presidentit të Republikës së Shqipërisë

Gjeneralbrigade Piro Ahmetaj, zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është emëruar së fundmi këshilltar i Mbrojtjes së Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Me rastin e marrjes së detyrës së rëndësishme, gjeneral Ahmetaj dëshiron të përcjellë një mesazh për lexuesit e gazetës "Ushtria"



Gjatë vitit që lamë pas kam pasur dy intervista me gazetën tuaj, përkatësisht me rastin e 4 vjetorit të anëtarësimit të vendit tonë në NATO, (prill 2013) si dhe me rastin e gradimit dhe emërimit në detyrën e zv/SHSHPFA. Për këtë arsye mendoj se nuk është e nevojshme dhe as relevante për të dhënë një intervistë të zgjeruar. Megjithatë, si një mik konstant i gazetës "Ushtria", do të dëshiroja të ndaja me ju disa ndjeshmëri dhe mesazhe personale. Së pari, nëpërmjet këtyre rreshtave, dëshiroj t'i shpreh respektin e sinqertë dhe mirënjohjen e thellë presidentit të Republikës dhe njëherësh Komandantit të Përgjithshëm të FA, Bujar Nishani, për përzgjedhjen time në këtë detyrë të lartë. Në shtesë të një investimi konstant në strukturat strategjike të sigurisë, kjo detyrë e lartë më bën të ndihem jo vetëm i nderuar,

por maksimalisht të vetëdijshëm dhe njëherësh të përgjegjshëm për sfidën institucionale që ajo mbart. Së dyti, në të gjitha rastet, ndarja fizike është një ngjarje emocionale, ose siç i thonë amerikanët "divorci gjeografik" me institucionin e MM/SHP ku kam pasur privilegjin të angazhohem në 15 vitet e fundit, padyshim që ka një impakt të madh tek unë. Për të dhënë një mesazh përmbledhës përsa i takon pjesës njerëzore dhe emocionale, po përpiqem të bëj një përpjekje gazetareske, duke ndarë sinqerisht me lexuesit dy ngjarje familjare të thjeshta, por mendoj edhe shumë kuptimplotë: Shumë vite më parë, kur familja ime u zhvendos nga një krahinë e Tepelenës në rrethinat e Vlorës, prindërit e mi puthën pragun e shtëpisë ku kishin kaluar jetën, atë prag që e kishin ndërtuar me shumë mundime dhe sakrificë. Rasti i dytë është më i freskët, ka

të bëjë me djalin tim Arlindin, që është duke studiuar në vitin e tretë të Universitetit të Hagës. Mbas gjashtë vjetësh, festat e këtij fundviti im bir i kaloi në Atdhe. Jam ndjerë shumë krenar, kur disa të afërm dhe miq më thanë se, pasi mbërriti në Hagë, në imazhin e tij në "Facebook" ka shkruar: "Left from my country I love so much ... , went to where I need to be ...", - e shqipëruar: "ika nga vendi që dashuroj kaq shumë, gjendem aty ku kam nevojë të jem..." Edhe pse në rrethana krejt të ndryshme, në distanca kohore të mëdha, "pragu" është një mesazh i fortë simbolik për mua. Ndaj unë nuk do të puth pragun e kalimit përtej Institucionit të Mbrojtjes, por sigurisht, përullem para tij me përunjësi të sinqertë, ashtu sikundër përullem para të gjithë epurveve, kolegëve, bashkëpunëtorëve dhe miqve, bashkudhëtarëve të rrugëtimit tim të gjatë 15

vjeçar nën çatinë e këtij institucioni. Pikërisht me këtë rast, përullem pa asnjë mëdyshje para "pragut", ku jo vetëm u rrita profesionalisht, ku u promovova nga kapiten në gjeneral, ku u shkolluan dhe u promovuan suksesshëm fëmijët, por mbi të gjitha përullem me krenari profesionale para "pragut të shtëpisë" që më është dhënë privilegji për të kontribuar modestisht në një proces reformash të jashtëzakonshme dhe të vështira, që u kurorëzuan me anëtarësimin e merituar, me finalizimin e procesit të integritimit të plotë në aleancën më të fuqishme ushtarake të globit, por edhe në aleancën e promovimit të vlerave më të larta njerëzore. Me këtë rast, i siguroj të gjithë se kjo ngjarje, ky promovim, më bën edhe më përunjësisht të detyruar për të kontribuar me gjithë mundësitë e mia në përmirësimin e sistemit të Sigurisë Kombëtare.

Ju faleminderit!

OPINION

Procesi për promovim e karrierës së ushtarakut, përbën një hap vendimtar për zhvillimin e personelit në FA

Kritere, standarde dhe korrektësi - kështu duhet të zgjidhet më i miri

Angazhimi i kalimit në ushtri profesionale, detyrimisht shoqërohet me sigurimin e elementëve të njësuëshmërisë dhe barazvlefshmërisë për ushtarakët e të gjithë kategorive, si ushtar profesionist, nënoficer dhe oficer. Vitet e fundit Forcat e Armatosura janë ndeshur me kontingjente disi ndryshe nga tradita e mëparshme, nga ushtarët profesionistë deri tek nënoficerët e trupës. Në këto kushte janë krijuar vështirësi në konceptim dhe aq më tepër në adaptimin e tyre në strukturat tona. Për më shumë, lindi e nevojshme siguriimi i praktikave të duhura që lidhet me mënyrën e të kuptuarit të procesit, ndjekjen e hapave për përfshirjen e tyre në sistem, siç janë kryerja e studimeve përkatëse, përgatitja e planeve dhe procedurave për veprim, siguriimi i aktivizimit të plotë dhe ndjekja e ecurisë normale. Por, çfarë është bërë dhe kush është synimi, janë çështje që mbi të gjitha kërkojnë analizë, vlerësim dhe vendimmarrje për të arritur standardin e duhur. Aktualisht Forcat e Armatosura zotërojnë një sistem të automatizuar të menaxhimit të personelit, i cili është mjaft i domosdoshëm për të analizuar gjendjen në kohë. Kuptohet për shkak edhe të traditës, përvojës apo dhe rëndësisë, praktika për personelin oficer është disi më e konsoliduar se sa për nënoficerin apo aq më tepër për ushtarin profesionist. Ndërkohë që synohet njësimi dhe siguriimi i ecurisë me të njëjtin rritim edhe për këtë kategori ushtarakësh. Një pyetje që mund të shtrohet, cila është gjendja? Ndoshta prurjet kanë qenë të niveleve të ndryshme, të cilat nuk kanë sjellë detyri-

misht standardin e kërkuar, por sistemi i selektimit të vazhdueshëm dhe kualifikimi i ushtarëve profesionistë dhe nënoficer ka prodhuar kontingjentin që kemi sot. A është ky kontingjent më i miri, përgjigjja mund të jetë dhe po dhe jo. A ka vend për përmirësim? Pa dyshim që po. Kur kalojmë tek pyetja si? Atëherë këtu duhet të jemi të matur, pasi kërkohet të identifikojmë situatën, analizojmë gjendjen, të pranojmë mungesat apo gabimet dhe mbi të gjitha të bëjmë korrigjimet e duhura në kohë, ku në themel mbetet rivlerësimi analitik i planifikimit përkatës. Një masë tjetër e rëndësishme është vlerësimi periodik i ushtarakut, ndjekja hap pas hapi gjatë procesit të kryerjes së veprimtarisë nga çdo ushtarak, pavarësisht nga grada apo vendi që zë në FA. Ashtu si dhe veprimtaria në punë ndiqet ecuria e përgatitjes fizike, e kualifikimeve pasuniversitare apo gjuhësore, duke krijuar praktikën e plotë për vlerësim. Parë në këtë këndvështrim, mbi bazën e planifikimit për kurse institucionale, sigurohet mundësia e përzgjedhjes të më të mirëve, duke ndikuar drejtpërdrejt në siguriimin e një procesi normal dhe efikas promovimi në gradë e detyrë. Si konkluzion, ndjekja rigorozë e këtyre procedurave, për një konkurrencë të drejtë, të baraspeshuar, të monitoruar dhe transparente, është një garanci më shumë për të siguruar kontingjentin më të mirë në shërbim të forcës së ardhme. E rëndësishme është të kuptohet nga të gjithë se të përzgjedhës më të mirin, të mirën për kualifikim, promovim në gradë e detyrë, duhet ti referohesh domosdoshmërisht kritereve dhe standardeve të duhura dhe

njëkohësisht ti zbatosh me korrektësi ato. Konkretisht kërkohet së pari, zbatimi i procedurave ligjore, së dyti identifikimi i personave me aftësi të spikatura individuale dhe së treti aftësi dhe merita që të dallojnë nga të tjerët. Respektimi i këtyre normave, bërja e tyre transparente, krijimi i shanseve të barabarta jep mundësinë që të zhvillosh, promovosh më të mirët dhe njëkohësisht të lartësosh njësinë/repartin ku shërben në interes të zhvillimit të Forcave të Armatosura. Parë në këndvështrimin praktik, Forcat Tokësore krahas kritereve bazë ligjore kanë përgatitur dhe vënë në funksionim udhëzime me rregulla/kritere që duhet të plotësojnë ushtarakët qofshin këta ushtarë profesionistë apo nënoficerë për të siguruar kualifikimin apo më tej promovimin në gradë e karrierë. Kriteret mund të jenë të shumta, por më kryesorët ku konkurrenca duhet të fokusohen janë: kurset institucionale bazë të ndjekura nga aplikanti, vlerësimet vjetore (2-3 vitet e fundit), rezultatet e testeve intelektuale/profesionale, dhe fizike, disiplina dhe paraqitja e jashtme, arsimimi dhe kualifikimi shtesë, pjesëmarrja në misionet dhe eksperiencat të tjera jashtë vendit, medalje dhe dekoratë e marra, etj. Secili nga këto elementë ka peshën specifike të tij dhe të marrë në kompleks, krijojnë portretin e plotë të ushtarakut në garë, qoftë për kualifikim të mëtejshëm apo qoftë për promovim në gradë. Vlen të theksoj se elementët e mësipërm mund të jenë të plotë ose jo, të cilët përcaktohen në varësi të objektit të konkurimit. E gjithë kjo praktikë kalon për vlerësim nga komisioni përkatës, vendimi i të cilit përbën themelin e ecurisë

në karrierë. Me të drejtë secili mund të pyesë, si ndiqen këto procedura apo më mirë rregulla? Në Forcat Tokësore hap pas hapi këto rregulla po kthehen në norma, të cilat nuk mund as të devijohen por as të mos respektohen. Aktualisht kaluam fazën e përzgjedhjes së personelit që do të ndjekë kurset institucionale për nëntetar (kursi fillestar i nënoficerit) dhe rreshter (kursi i avancuar i nënoficerit), e cila u zhvillua në përputhje me udhëzimet dhe procedurat përkatëse, duke bërë të mundur përzgjedhjen e më të mirëve dhe mbi të gjitha praktika e ndjekur ishte transparente për të gjithë konkurrenset. Me plot bindje them se nëse këto procedura ndiqen, personeli pjesëmarrës në konkurrim, është i vetëdijshëm për vendin që zë në skemën e përgjithshme. E përsëris, transparenca në këtë proces, lehtëson vendimmarrjen dhe siguron përzgjedhjen e më të mirëve/ të mirave. Të kthehesh në retrospektive, shikon se për shkak të prurjeve mjaft të mëdha të ushtarëve profesionistë, si dhe të ndryshimeve strukturore të bëra vitet e fundit, mbetet një kontingjent, i cili preket nga promovimi në gradë, për pasojë një pjesë e tyre duhet të ndërpresin karrierën ushtarake. Gjithsesi, përsëri gara është e hapur, më të mirët kanë shansin që të vazhdojnë karrierën e të kontribuojnë në FA. Konkretisht janë një numër i konsiderueshëm ushtarësh profesionist, të cilët janë në garë të marrin gradën e nëntetarit, ku do të përfitojnë më të mirët dhe pjesa tjetër detyrohen të lenë shërbimin në FA. Një aspekt tjetër që kërkon vëmendje është praktika ligjore e shërbimit në

FA, e cila ka nevojë për përditësim, pasi nga përvoja e krijuar koha e qëndrimit në FA e personelit ushtar profesionist prej 6 vjetësh është mjaft e shkurtër. Ky proces është parë në aspekt të dyanshëm si atë individual, ku ushtaraku ka të domosdoshme të qëndrojë më gjatë në profesionin që ka zgjedhur dhe nga ana tjetër, Forcat e Armatosura, e lirojnë këtë kontingjent në kulmin e karrierës dhe për më tepër nuk arrin që të sigurojë benefitet që janë shpenzuar për ta përgatitur këtë kontingjent, një masë e domosdoshme për tu patur në konsideratë është zgjatja e kohës së qëndrimit në detyrë të ushtarit profesionistë, nga 6 vjet që është aktualisht, duke e dyfishuar atë. Momentalisht të duket sikur frytet e këtij procesi janë disi të pa dukshme, por me bindje them se për një periudhë të shkurtër kohore, një apo dy vjeçare, do të ndjehet dukshëm rezultati i këtij procesi. Mbi të gjitha, personeli ushtarak; ushtar profesionistë e nënoficer, ashtu si dhe oficerët do të ndërgjegjësohen për detyrimin e zhvillimit personal për të mundësuar ngritjen në gradë e karrierë. Esenciale është të ndiqet i njëjti standard, të flitet me të njëjtën gjuhë, të ketë transparenca dhe korrektësi dhe mbi të gjitha të ketë siguri dhe bindje secili të mendojë se "po futem në garë dhe do të vlerësohem për atë që e meritoj".

Kolonel Dilaver HOXHA,
zëvendëskomandant i FT
Nënkolonel Bardhyl NUREDINI,
shef i Degës së Personelit, FT

Shqipëria e Luftës së Ftohtë, në dokumentet Sekrete të NATO-s

ALBERT HITOALIAJ

Kohët e fundit, NATO ka de-klasifikuar disa prej dokumenteve Sekrete të Aleancës, të cilat i përkasin periudhës së Luftës së Ftohtë. Në to jepen detaje e të dhëna për Bllokun Lindor dhe Perëndimor në përgjithësi dhe për shtete apo grup-shtetesh të ndryshme të cilët ishin në brendësi të këtyre ndarjeve. Mes këtyre dokumenteve Sekrete tashmë të de-klasifikuara, pjesë e arkivave të Aleancës, ka edhe nga ato që flasin për Shqipërinë dhe situatën e saj. Disa prej tyre do të sillen për herë të parë në shqip, në faqet e gazetës "Ushtria". Dokumenti i mëposhtëm është një raport i cili flet për situatën në Shqipëri dhe është i ndërtuar mbi bazën e një informacioni që e kanë formuluar ekspertë italianë. Këto dokumente mund të jenë të vlefshme për studiues ushtarakë apo civilë.

COPY NR 16

PËRFAQËSUESIT E KËSHILLIT
TË ATLANTIKUT TË VERIUT

DOKUMENT SEKRET

AC / 2 - D/11

VETEM ANGLISHT


22 qershor 1951

GRUPI I PUNËS POLITIKE

INFORMACION SHITESË PËR
KUSHTET USHTARAKE POLITIKE
DHE EKONOMIKE NË SHQIPËRI
(Memorandum nga Delegacioni Italian)

I. Kushtet politike

Kushtet e brendshme të Shqipërisë, ashtu siç vlerësohen nga ana e Legatës italiane dhe Zyrave Konsullore fqinje, mbeten serioze, edhe pse kjo do të ishte një ekzagjerim i madh nëse do të flitej për një revoltë apo luftë civile. Kapja Sovjetike mbi vend është duke u bërë gjithnjë e më e fortë. Të rejtat e përlëshjeve pranë Elbasanit, mes guerrillasve që udhëhiqen nga Muharrem Bajraktari dhe forcave qeveritare, nuk janë të konfirmuara, por është fakt se në atë zonë ka disa qendra aktive trazirash, dhe gjithashtu edhe në afërsi të liqenit të Prespës. Ka një lëvizje të gjerë anti-komuniste në Greqi, në mes të ndjekësve të ish Mbretit Zog, sidomos mes atyre refugjatëve që janë në bashkëpunim të ngushtë me Ali Këlcyren dhe Ballin Kombëtar. Megjithatë, këta refugjatë shqiptarë, i shohin me dyshime të thella prirjet e pretenduara imperialiste / ekspansioniste të drejtuesve ushtarakë grekë. "KOMINFORM" është i angazhuar në një propagandë ak-



tive anti-jugosllave mes fshatarësisë shqiptare. Një nga argumentet më popullore dhe më efektive kundër Jugosllavisë, është trajtimi i keq i minoritetit shqiptar në atë vend; një tjetër është përgatitja ushtarake e Jugosllavisë kundër shteteve satelitore në përgjithësi dhe Shqipërisë në veçanti.

II. Kushtet ushtarake

Madhësia aktuale e Forcave të Armatosura të rregullta shqiptare, nuk është i njohur, por vlerësohet se Shqipëria mund të grumbullojë lehtë

SECRET AC / 2 - D/11

Faqe 2

në kohën e sotme 40-50 mijë burra nën armë. Pajisjet e këtyre ushtarëve, morali i të cilëve është i ulët, sidoqoftë nuk mund të jenë veçse të varfra. Nuk ka asnjë të dhënë mbi trupat ruse që ndodhen në Shqipëri, edhe pse një numër në rritje, teknikësh dhe këshilltarësh rusë ndodhen në vend, ku disa prej të cilëve janë të angazhuar në punimet e fortifikimeve bregdetare. Vëmendje e veçantë i është kushtuar rrugëve të mëposhtme :

a) Rruga (68 km), e cila do të lidhë Tropojën, në afërsi të kufirit jugosllav, me Krumën, Kolgecin dhe Pac (shënim: sipas emrit në origi-

nal), për ndërtimin e të cilës janë punësuar 800 punëtorë. Një degë e kësaj rruge strategjike (13 km) është gati për përdorim; një shtesë prej 20 km duhet të përfundojë deri në fund të qershorit. Është planifikuar për të punësuar në ndërtimin e kësaj rruge 3.500 punëtorë, kryesisht nëpërmjet rekrutimit.

b) Rruga Milot - Lezhë - Shkodër, e cila kohët e fundit është riparuar.

c) Rruga Lushnjë - Ura Vajgurore, gjithashtu e riparuar kohët e fundit.

d) Rruga Dormish - Thollego (12 km) (Shënim: emrat janë sipas originalit)

13, BELGRAVE SQUARE,
LONDON, S.V.I

Përmbajtja e dokumentit original

COPY NO. 16

NORTH ATLANTIC
COUNCIL DEPUTIES

SECRET

DOCUMENT

AC/2 - D/11

Eng. ONLY

22nd June, 1951.

POLITICAL WORKING GROUP

ADDITIONAL INFORMATION
ON MILITARY POLITICAL AND
ECONOMIC CONDITIONS IN

ALBANIA

(Memorandum by the Italian Delegation)

I. Political Conditions

The internal conditions of Albania, as appraised by the Italian Legation and neighbouring Consular Offices, remain serious, although it would be a gross exaggeration to speak of a revolt or civil war. The Soviet hold over the country is becoming more and more firm. News of clashes near Elbasan, between partisans under General Muharem Barakbara and Government forces, have not been confirmed but it is a fact that there are several active centres of unrest in that zone, and also near the Lake of Prespa.

There is a widespread anti-communist movement in Greece among the followers of ex King Zog, notably among these refugees who are in close association with Ali Klyssura and the Belli Kombetare. These Albanian refugees, however, regard with deep misgivings the alleged imperialistic tendencies of the Elicnic military leaders.

The Cominform is engaged in active anti-Yugoslav propaganda among the Albanian peasantry. One of the most popular and effective arguments against Yugoslavia is the bad treatment of Albanian minorities in that country; another is the military preparations of Yugoslavia against the satellite states in general and Albania in particular.

II. Military Conditions

The actual size of the Albanian

regular armed forces is not known, but it is estimated that Albania could easily muster

SECRET

AC/2 - D/11

2.


muster at the present time between 40 and 50 thousand armed men. The equipment of these soldiers, whose morale is low, could not, however, be other than poor. There is no indication of Russian troops being maintained in Albania, although an increasing number, of Russian technicians and advisers are in the country, some of whom are engaged in work on coastal fortifications. Special attention is given to the following roads:

a) The road (68 Kms) which will Join Tropoje, near the Yugoslav frontier, to Krume, Kolgeci and Pac, on the construction of which 800 workmen are employed. A trunk of this strategic road (13 Kms) is ready for use; an additional 20 Kms. are to be completed by the end of June. It is planned to employ in the building of this road 3,500 labourers, mostly by way of recruitment.

b) The Miloti - Alessio - Scutari road which has recently been repaired.

c) The Lushnia - Ura - Vajgurore road, also recently reconditioned.

d) The Dormish - Thollego road (12 Kms).





*Nga komandant/
rektor i AFA, kol.
Prof. Asoc. Dr.
Agim Sula, zonjës
Patricie Nugee ju
dha Certifikatë
Mirënjohje me
motivacion: "Për
kontribut të dhënë
në mbledhjen dhe
pasurimin e li-
brave të rrallë për
Skënderbeun, në
gjuhë të huaj kudo
në botë"*

**Zëvendëskomandant i KDS-së,
kolonel Kuçi: Vlerësoj kontributin e
saj si koleksioniste**

Problematika e kësaj veprimtarie është disi e veçantë, sepse këtu kemi të ftuar një zonjë të nderuar angleze, Patricie Nugee, e cila, duke dëgjuar për Skënderbeun, këtë figurë historike të një populli të vogël, filloi të koleksiononte libra të rrallë të shkruar nga autorë e vende të ndryshme të botës. Unë e vlerësoj kontributin e saj, e përgëzoj për këtë mision dhe na jep ne njëkohësisht edhe një mësim për të mbledhur dhe ruajtur gjerë me vlerë dhe të rralla siç ajo ka për librat e shkruara për Skënderbeun. Në luftën 25 vjeçare kundër perandorisë Otomane, Skënderbeu ka shpalosur koncepte politike e strategjike të qarta, si dhe aftësinë të gjejë zgjidhje të drejta nëpërmjet luftës së armatosur ose edhe veprimtarisë diplomatike në varësi nga situata. Rrjedhojë e këtyre koncepteve ai plotësoi me sukses një varg detyrash politiko-strategjike tepër të rëndësishme. Të befashuar nga këto arritje në historiografinë botërore ndërmjet të tjerash është shtruar çështja e metodave të luftës së armatosur të përdorur nga Skënderbeu në krye të një ushtrie të vogël kundër ushtrisë më të madhe e më të fuqishme të kohës. Analiza e luftërave dhe betejave të zhvilluara tregoi qartë se Skënderbeu duke qenë një njuhës i thellë i artit ushtarak, kombinoi me mjeshtëri luftën e rregullt dhe luftën guerile. Për t'u ndeshur me kundërshtarin jo vetëm më metodat e luftës partizane, por edhe me beteja në fushë të hapur, Skënderbeu i duhej së pari të ndërtonte një ushtri të rregullt. Ushtria e Skënderbeut me mundësi mobilizimi të një efektivit prej 15-20 mijë luftëtarësh, e aftë të përhapje me shpejtësi në fushën e luftës, përbëhej nga garda pretoriane repartet e kufirit dhe forcat ndihmëse. Krijimin e kësaj ushtrie e mundësonte zbatimi i parimit "burrë për shtëpi" dhe hartimi i listave të rekrutimit. Ky sistem që ka tiparet e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, ishte mjaft përparimtar për kohën. Skënderbeu krijoi kështu i pari në Evropë në periudhën e mesjetës ushtrinë e përhershme dy vjet para Karlit XII të Francës, i cili vetëm në vitin 1445 krijoi një lloj ushtrie të përhershme.

Aftësitë e shumanshme të Skënderbeut nxorën në dritë strategun e komandantin me famë botërore dhe i dhanë atij mundësi të drejtojnë dhe komandojnë një ushtri të vogël, por tepër të përgatitur kundër fuqisë ushtarake më të madhe të kohës dhe të arrijë fitore për 25 vjet. Tërheq



PATRICIE NUGEE SHEKULLIT TË XXI

Veprimtari për Skënderbeun

QLMI dhe QGJH e AFA organizuan një veprimtari për Skënderbeun, ku u prezantua koleksionistja e rrallë me libra për Skënderbeun, zonja Patricie Nugee. Qëllimi ishte të njihet puna dhe veprimtaria e bërë nga zonja Patricie Nugee, për mbledhjen dhe grumbullimin e koleksioneve të librave të rrallë për Skënderbeun. Në veprimtari morën pjesë drejtues të institucioneve, pedagogë të AFA-së, punonjës të bibliotekave në KDS-së, etj. Mori pjesë dhe zëvendëskomandanti i KDS-së, kol. Ruzhdi Kuçi, i cili dhe përshëndeti veprimtarinë dhe zonjën angleze. Drejtori i QLMI-së Bernard Zotaj, foli për librat e botuara për Skënderbeun në gjuhën shqipe, ndërsa drejtoresha e QGJH, Shqiponjë Dautaj, theksoi rolin e zonjës angleze për këtë punë fisnike të bërë në jetën e saj. Gjatë veprimtarisë u

mbajtën dhe materialet: Emblema dhe simbolet e familjes së Kastriotëve, një pasqyrë e tyre, prej specialistes së bibliotekës, Alma Canaj; Botime për figurën e Skënderbeut nga autorë të huaj, nga koleksioni i librave të zonjës Patricie Nugee, prej specialiste e bibliotekës së QGJH nga Nini Kadia, si dhe Skënderbeu, ky kombëtar i nderkombëtar i madh, nga shef i seksionit të librit, Pano Hallko. Nga komandant/rektor i AFA, kol. Prof. Asoc. Dr. Agim Sula, zonjës Patricie Nugee ju dha Certifikatë Mirënjohje me motivacion: "Për kontribut të dhënë në mbledhjen dhe pasurimin e librave të rrallë për Skënderbeun, në gjuhë të huaj kudo në botë". Më tej në veprimtari u shikua dhe një dokumentar për Skënderbeun si dhe librat e rrallë të koleksionistes të prurë enkas për këtë veprimtari.

A.H

vëmendjen vlerësimi i një specialisti e teoricieni të artit ushtarak të shek. XVIII gjeneralit anglez Xhejms Uolf, i cili shkruan se: "do të ishte një punë e paçmueshme po të mund të sigurohej një përshkrim i mjaftueshëm i veprave të Skënderbeut, sepse ai shkëlqen midis gjeneralëve të kohëve të vjetra dhe të sotme si udhëheqës i një ushtrie të vogël mbrojtëse". Sigurisht teoricieni anglez, i cili e ngre heroin tonë mbi gjithë gjeneralët e kohërave të vjetra e të reja ishte kryesisht i interesuar për veprat e një udhëheqësi të një lufte të rregullt sesa të një komandanti të luftës së çetave. Skënderbeu dhe ushtria shqiptare hapën një front lufte në ekstremin perëndimor të Perandorisë otomane, por në një drejtim tepër të rëndësishëm gjeostrategjik. Personalitete të kohës e vlerësojnë luftën shqiptaro-osmane jo thjesht si një luftë për mbrojtjen e Shqipërisë, por si një betejë për mbrojtjen e Evropës, që dha një ndihmesë të paçmueshme për qytetërimin evropian. Ndërsa Skënderbeu vlerësohet si gjenerali guximtar dhe strategu që askush nuk e zotëron më mirë se ky mjeshtër i luftës çka bëri që Papa Kaliksi IV ta emërojë kapiten të përgjithshëm të Selisë së Shenjtë. Perandoria otomane, në planet e saj të zgjerimit kishte drejtime strategjike tepër të rëndësishme, por pa dyshim një nga këto drejtime ishte edhe ai i Shqipërisë, që ju bë pengesë planeve të sulltanit për t'u hedhur në Evropë. Kujtojmë këtu se Skënderbeu dhe ushtria e tij u ndeshën dhe fituan kundër dy sulltanëve më të mëdhenj të Perandorisë dhe 15 gjeneralëve ndër më të zgjedhurit e saj. Një vend veçanërisht të rëndësishëm zinte Skënderbeu dhe ushtria shqiptare në planet e kryqëzatës kundër Perandorisë. Edhe Schmid-i, që e kritikon Skënderbeun, na pohon se "sundimtari arbër po hynte gjithnjë e më shumë në qendër të

planeve strategjike në perëndim dhe në Anatoli". Këto vlerësime për heroin tonë kombëtar Skënderbeun janë plotësisht të dokumentuara, të vërtetuara e të gjithë pranueshme, janë njëherazi një dëshmi e qartë e madhësisë së këtij personaliteti historik. Skënderbeu është një realitet i fuqishëm historik. Në qoftë se personaliteti i Skënderbeut ka arritur ato kulme, ato përmasa, që koha dhe popujt i kanë dhënë dhe fuqinë e një miti, kjo është një dëshmi tjetër e qartë e madhësisë së tij.

Unë e vlerësoj veprimtarinë që po organizoni dhe do të dëgjoj me kujdes e interes materialet e përgatitura.

**Patricia Nugee, koleksioniste e
veprave të shkruara
për Skënderbeun**

Zonja Patricia Nugee në vijimësi ka organizuar aktivitete, si dhe ka marrë vlerësime në ekspozita e librave të koleksionit dhe të fondacionit, anëtarësim në shoqatën anglo-shqiptare, dekorime e vlerësime. Gjatë gjithë jetës së saj ajo ka organizuar këto ekspozitat me vepra të shkruara për Skënderbeun në: Universiteti i Cambridge, në vitin 1996, Eton college në vitin 2001, BBC Londër, seksioni shqiptar, në vitin 2003, Kosovë (Prishtinë) në vitin 2004, Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë në vitin 2004, Mal i Zi/Ulqin në vitin 2005, Kalabri/Frashineto në vitin 2005, Maqedoni/Shkup në vitin 2007, Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2008, Kosovë (Orlan) në vitin 2011, Barcelonë në vitin 2012. Aktivitete të fondacionit janë: Ekspozita fotografike "Sëire in Albania", promovimi i librit të Jozef Sëire "Shqipëria, ngritja e një mbretërie", promovimi i librit të David Smile "Vitet shqiptare '43-'45", përkujtimore për 100-vjetorin e Ihsan Toptanit.



Zonja Patricia Nugee është anëtare e shoqatës anglo-shqiptare prej mbi 40 vjet, sekretare e shoqatës mbi 10 vjet, organizatore e aktiviteteve, përtej trojeve shqiptare, pjesëmarrëse në aktivitetet e ambasadës Shqiptare në Londër, lektore në përvjetorët e pavarësisë së Shqipërisë. Ajo është dekoruar dhe ka marrë vlerësime si: Medalje Mirënjohje nga Presidenti Alfred Moisiu, Medalje Mirënjohje "Nënë Tereza" nga Presidenti Ibrahim Rugova, Qytetare Nderi e Prishtinës, Çertifikatë Mirënjohje nga Bashkia Berat, Çertifikatë Mirënjohje nga Bashkia Ulqin dhe Çertifikatë Mirënjohje nga Akademia e Forcave të Armatosura. Ajo ka themelura dhe Fondacionin Kulturor "Patricia Nugee" në qershor 2007, ku promovon vlerat kulturore shqiptare, boton dhe promovon libra, organizon ekspozita dhe konferenca, organizon shkëmbime kulturore ndërmjet Anglisë dhe Shqipërisë. Ka koleksionin e librit të Marin Barleti në këto gjuhë të Evropës: Historia e jetës së Skënderbeut, Princit të Epirit - Romë, 1510, mbi jetën, zakonet dhe luftërat e Skënderbeut kundër Turqve; Strasburg, 1537, Kronika e kryetrimt Princ e Kapedan, Gjergj Kastriotit, Mbretit të Epirit, (përkthyer nga portugalishtja) Madrid, 1597, Jeta e Princit dhe zotit Gjergj Kastrioti, kryetrimt Skënderbe, (përkthyer në gjermanisht) Frankfurt, 1561, Historia e Kryetrimt dhe Shpirtmadhit Skënderbe, Pietro Roka, Venedik-1580. Zotëron portrete të Skënderbeut nga librat: Historia e Gjergj Kastriot Skënderbeut, Princ i Epirit e Shqipërisë; Giovanni Maria Biemmi, Historia e Gjergj Kastriot Skënderbeut, Breshia 1742; Thomas Ehincop, "Skënderbeu ose dashuri dhe liri", Tragjedi, Londër 1747; Antonio Zoncada, Skënderbeu, Histori shqiptare e shekullit

XV, Milano 1874; Plutarch, Jetët e grekëve dhe romakëve fisfikë dhe jetët e 20 personaliteteve të tjera si Skënderbeu etj. (Londër, 1657); Life and heroic actions of George Castriot, 1810 Sterling (Scotland); Scanderbeg a tragedy y Mr. Havard, published 1733, London; Teissier, Amsterdam, 1710; Pontamus, published in Hannover 1609; Scanderbed, Luis de Meneses, Lisboa, 1688; A brief account of the life of George Scanderbeg, London, 1735; Pontamus, 1609; Commentario, Giovio, 1541; Francus, 1584, Venice; Sarocchi, 1606, Romë.

Nini Kadia

**Emblemat dhe simbolet e
Familjes së Kastriotëve**

Gjergj Kastrioti Skënderbeu ishte simbol i mençurisë dhe i bashkimit ndërkombëtar. Shteti shqiptar i bashkuar nën drejtimin e Skënderbeut, kishte simbolet e veta. Misteri i simboleve ishte dija e tyre e përcjell në kode. Kastriotët mbanin stemën e shqipes me dy kokë. Stemat i vendosnin në veshje/përkrenare. Përkrenarja e Skënderbeut u bë pjesë e pandashme e heroit tonë Kombëtar. Stemat tregonin evoluimin në dije/art/shkencën mistike, mbarë evropiane. Emblema kastriotase simbolizonte: Aleanca të brendshme me familje fisnike shqiptare, Pushtet që u përdorë nga Skënderbeu për "aneksim" dhe bashkim të feudeve të ndryshme të Shqipërisë. Shqiponja ishte pjesë e emblemsë së familjes Kastrioti e cila e ka zanafillën në perandorinë bizantine. Emblema e Gjergj Kastriotit me shqiponjën dy krenore shfaqet në vitin 1451. Ju dhurua Skënderbeut nga Alfonsi i V-të, Mbreti i Napolit. Stema e shqipes me dy kokë - simbol pushteti nga: Kastriotët, Arianitët, Muzakajt,

UJGEE, - EDIT DURHAMI I

I-të, "CERTIFIKOHET" NGA FA



Skënderbeu, ky Kombëtar dhe Ndërkombëtar i Madh...

NGA PANO HALLKO

Më së pari më duhet të them dy fjalë për zonjën Patricia. Ne, si komb i jemi por edhe duhet t'i jemi mirënjohës kësaj zonje për atë që bën në funksion të ndriçimit të faqes më të ndritur të Historisë së këtij kombi. Kjo nuk është Patricia, por është Edit Durhami e shekullit të XXI-të. Ndërsa Edit Durhami e shekullit XX-të ngriti në këmbë Londrën për dramën që luhej në kurrizin e kombit më të vjetër të Ballkanit, kjo zonjë ka marrë një detyrë dyfishe: I grumbullon librat për Skënderbeun nga e gjithë bota, por edhe vjen e më nderon mua të padenjin, duke na i sjellë ato këtu, në Tiranë, bashkë me hapëset plastike të librave! Shteti ynë e ka për detyrim nderi të ngrejë dy monumente: 1-Monumentin e Edit Durhamit, dhe 2- Monumentin e Aristidh Kolës. Por edhe të nderojë dhe mbështesë siç i takon, zonjën që na nderon në këtë mënyrë. Gjergj Kastriotin nuk e nxë "Djepi" i një populli, "Djepi" i një kombi, "Djepi" i një shteti, e as "Djepi" i një Kontinenti. "Jemi kombi më i vjetër i Europës" - themi ne. Por si komb, ne nuk mund të identifikoheshim e as të konfiguroheshim para të tjerëve, pra para kohës kur në Europë të paktën u themeluan shtetet-kombe. Ne, si Komb, kemi vetëm "Dy Kombëtarë".



Ata që i kanë rezistuar Kohës, ata që Koha i prodhoi apo i thirri. Kemi Heroin tonë Kombëtar-Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, por kemi edhe Poetin tonë Kombëtar-Naim Frashërin. I pari, pra Heroi, na dha forcën dhe shpirtin e vet. Por 5 shekuj ishin shumë për të ruajtur vlagën e veprës së shpatës së tij. Duhej të vinte një Poet Virtuoz, i papërsëritshëm, ai që do të shkruante në Shqipëri Historinë e të Parit, në mënyrën e vet, që ta bënte të asimilueshme për "stomakun" shqiptar, e t'u jepte një Motiv shqiptarëve për të qenë e për t'u ndjerë të tillë. Qe shkruar një Histori, por vetëm 50 vite pas vdekjes së heroi tonë Kombëtar nga Marin Barleti. Por dhe ajo që shkruar në latinisht, edhe pse me fjalë shqipe. E shqiptarët nuk e njihnin atë Gjuhë, thjesht edhe për faktin se nuk kishin alfabet e gjuhë të shkruar. Sepse edhe "Meshari", ishte shkruar në një tjetër gjuhë, me tjetër alfabet. Princi Gjon Kastrioti, babai i Strategut të ardhshëm në martua me princeshën Vojsava, bija e një feudali të pasur. Për 19 vjet në këtë familje erdhën 9 fëmijë; katër djem dhe pesë vajza. Me blerje, më së shumti me rrëmbime dhe grabitje me forcën e shpatës, ai bëri një pasuri. Por veç këtyre, ai shfaqte një aftësi të jashtëzakonshme organizative, e për këtë arsye krijoi një principatë të fuqishme, principatën e Kastriotëve. Aftësitë e tij të spikatura, nuk mund t'i shpëtonin as syrit të Lindjes, as atij të Perëndimit, doemos Italisë. Për këto arsye, qytet-shtetet italiane Venecia e Napoli, i shprehën atij dëshirën për bashkëpunim. Në muajin Maj 1408, Gjon Kastrioti me ftesë të Senatit të Venecias vizitoi qytetin. Atë ditë Senati e shpalli "Qytetar Nderi të Venecias". Ndërsa kreu i kishës katolike Papa Eugeni i IV-ërt, e priti në Vatikan, duke i premtuar ndihma atij. Kur u kthye në atdhe, Kisha Lindore (e krishterë) e akuzoi Gjonin për largim nga feja e tij. Përgjigja e tij ishte: "Zoti është një për të gjithë. Fe ka shumë. Njeriu ka të drejtë t'i besojë të gjitha, ose asnjërin. Unë mund të bëhem edhe mysliman". Megjithatë, ai nuk e bëri këtë. Në vitin 1409, në shkëmbim të haraçit të papaguar dhe në shenjë garancie për bindje, sulltani i mori djalin e madh peng, u vendos kështu një armëpushim. Tek princat e tjerë shqiptarë, ai nuk gjente asnjë lloj përkrahjeje. Ata nuk kishin harruar që ky i fundit u pat grabitur me forcën e shpatës toka dhe pronat. Pra, ata jo vetëm nuk e ndihmonin, por iu drejtuan për ndihmë turqve. Sipas kërkesës së tyre, u ngritën në Shqipëri garnizonet e para turke. Qysh atëherë u vendos garnizoni turk në kalanë e Beratit, që do të rrinte aty deri në ikje të Turqisë, në vitin 1912. Në këto kushte, ai iu drejtua për ndihmë Papës, atij pape që i premtoi ndihmë. Por përgjigja e tij ishte: "Do t'i lutem zotit për mbarrëvajtjen e luftës suaj kundër turqve": kurse Venecia të paktën tipikisht pranoi se do të hynte në luftë kundër turqve, në krah të Gjonit. Kurse në verën e vitit 1415, turqit i morën peng edhe djalin e vogël Gjergjin. Gjithmonë si garanci për nënshtrim ndaj Perandorisë. Kështu Gjergjin 9 vjeçar duke e ditur se nga vinte, e futën në shkollën elitë "Iç Oqlan", e cila përgatiste shefat e mëdhenj ushtarakë të ardhshëm... Gjergjin ia besuan një vejuje të arsimuar tridhjetetë vjeçare, Selimesë. Burri i saj ishte vrarë në luftë në muret e Ankarasë. Ajo u lumturua nga dhuratat që iu bë, e mbajti në shtëpinë e saj, e rriti duke i ofruar atij gjithçka mund të ofronte një nënë e vërtetë, por edhe duke i folur vazhdimisht për rrënjët e tij. Dihet tanimë veprimet e tij për kthimin në Shqipëri, ashtu siç njihen edhe betejat e tij të fituara të gjitha. Ajo që duhet theksuar, është se pas Aleksandërit, Skënderbeu është i vetmi Gjeneral që njohu vetëm fitore. Prandaj një gjeneral i madh i kohëve, thoshte në shënime të tij: "Nuk kam njohur gjeneral më të madh se Skënderbeun në luftimin mbrojtës". Në nëntor të vitit 1444, fiks dy muaj pas fitores së parë të madhe kundër turqve, Gjergjin e ftoi për vizitë Papa Nikolla i V-të. Pas një orë bisede, ai e pyeti: "Çfarë ndihme kërkonin nga Vatikanin? Skënderbeu iu përgjigj: "Ju e dini që ushtria shqiptare mbeti e vetme në luftë kundër perandorisë otomane. Sulltani bëri

paqe me Hungarinë, po përpigjet të pushtojë të gjithë Ballkanin, e po e arriti këtë, radha u vjen juve. Ju paguani shumë para për mbështetjen e kryqëzatave, kurse ne mbrojmë portat tona dhe tuajat." - "Ne do t'i lutemi Madhërisë (Zotit) për fitoren e ushtrisë shqiptare. Por edhe ndihmë do ju jepet." - përfundoi Papa. Dhe e gjithë "ndihma" që iu dha nga kisha, ishte vetëm 2000 dukate. Edhe Senati i Venecias e priti me nderime të mëdha. Gjergji u kujtoi atyre se babai i tij Gjoni, ishte "Qytetar Nderi i Republikës së Venecias", ashtu siç u kujtoi edhe faktin se në vitin 1414, Venecia e kishte tradhtuar atë, duke mos e ndihmuar sipas marrëveshjes. Më mirë se kudo, ai u prit në Napoli, nga mbreti Alfons. Vatikanin kishte njohur tek Skënderbeu, strategun e talentuar dhe mbrojtësin e qytetërimit perëndimor.

Ushtri Numër Një i Krishtit

Kurse Venecia e shikonte edhe më ngushtë. Ajo vërtet e ndihmonte atë për mburojë që i ofrohej, por kishte edhe komunitetet e saj veneciane në Durrës dhe në Shkodër. Ndoshta për këtë, edhe i frikësohej forcimit të ushtrisë shqiptare. Prandaj Venecia jo rrallë fshehurazi, ndërsente princat shqiptarë kundër Skënderbeut. Në vitet 1445-1448, pati një periudhë paqeje, pra nuk pati luftëra. Në këtë periudhë Skënderbeu themeloi dhe konturoi plotësisht shtetin e tij me të gjithë elementet. U festua me protokolll dhe madhështi edhe 5 vjetori i ardhjes së Skënderbeut në Shqipëri. Fitorja e shqiptarëve në fushën e Domosdovës, i dah dorë atij të tregonte edhe elementë të tjerë të një burri shtet-bërës. Akordoi ndihma financiare për familjet e të vrarëve, por edhe të së plagosurve. Në dhjetor të vitit 1451, Papa i Romës, Nikolla i V-të, e ftoi Skënderbeun dhe i akordoi Titullin "Ushtri Numër 1 i Jezu Krishtit". Kjo nuk shkaktoi ndonjë entuziazëm të veçantë tek Skënderbeu. Shpjegimi për këtë qëndrim, erdhi përmes përgjigjes së tij: "Çdo vit në luftë me otomanët, shqiptarët derdhin gjak. Ranë në fushën e nderit djemtë më të mirë të popullit. Por u shkatërrua edhe ekonomia. Ne mbrojmë veten, por edhe juve. Na premtuar ndihma, por mbeten vetëm fjalë". Në çastin e largimit, Gjergji si rastësisht i tha Papës: "Sulltani nuk i largohet dëshira për t'u hakmarrë kundër Vatikanit për marshimet e Kryqëzatave, në të cilat janë vrarë qindra mijë myslimanë."

Shtet-bërës, një shekull para Makiavelit...

Në vitin 1456, Skënderbeu i ndodhën dy fatkeqësi: Vdiq Janosh Huniadi, i cili në krye të ushtrisë hungareze e priste tërbimin turk kundër Ballkanit-Shqipërisë. Por edhe nipi i tij Hamzai, me gjithë bashkëpunëtorin e Gjergjit, - Gjergj Balshën, me ndihmën e spiunëve turq e me paratë e tyre, e tradhtuan e shkuan në Stamboll. Të gjithë ne shikojmë një foto të Skënderbeut, e cila në fakt është pikturë. Në tëmthi dhe djathtë, ai ka një blanjë, e cila nga studiuesit interpretohet edhe si shenjë plage. Është ajo foto e njohur që zbukuron muret e Galerisë "Ufici" në Itali. Por, kush e bëri këtë pikturë? Ajo është piktura e punuar nga Xhentile Bellini në vitin 1466, bërë me porosi të Papës Pavli i II-të, ardhur në post pas vdekjes së Papa Piu. Tre organe kryesore pati shteti i Skënderbeut: Organi për mbrojtjen dhe përgatitjen e Ushtrisë, pra Shtabi i Përgjithshëm; Organi i politikës së jashtme dhe i veprimtarisë diplomatike, sot Ministri e Jashtme, dhe Organi i sigurimit financiar për veprimtarinë e shtetit. Ai hodhi bazat e Ushtrisë moderne. Njësia bazë luftarake ishte Kompania me 150-200 vetë. Batalioni kishte 10-15 kompani në përbërjen e tij. Ushtria e tij përbëhej nga repartet e gatishmërisë së përhershme dhe ato rezervë. E përhershmeja përbëhej nga repartet e kavalërisë dhe ato të këmbësorisë. Në ushtri thirreshin të rinjtë nga 18-35 vjeç. Brigada e kavalërisë shqiptare ishte tmerri i ushtarëve turq, ajo mund të realizonte detyra të rangut taktik dhe operacional. Hodhi bazat e stërvitjes moderne të ushtrisë. Ai pati dy detashmente zbulimi: -Dega e parë merrej me zbulimin e jashtëm. Njerëz shumë të afërt të vetë sulltanit, i siguronin të dhëna të karakterit tepër sekret. Kurse Dega e Dytë ishte zbulimi ushtarak. Ndërsa zbulimi me vrojtje, realizohej edhe në shtetet fqinje. Si shtetar, nuk mund të mos vërente faktin se popullsia po pakësohej për shkak të luftërave të pafundme ku ishin vrarë me mijëra të rinj. Vendi po humbiste fondin e tij gjenetik. Prandaj ai ndërmori reforma, ndau ngastra toke familjeve të varfra dhe me shumë fëmijë. Shpërbëu me të holla familjet e të rënëve, paguante edhe ushtarët e mobilizuar...

Në tetor të vitit 1467, Gjergji sëmurte rëndë nga malaria. Mjekët që erdhën nga Venecia dhe Roma, nuk mundën ta shpëtonin. Ethet e torturuan, ai me zor mund të hidhte disa hapa brenda dhomës. Janari i vitit 1468, hodhi dëborë të madhe, e cila me gjithë përpjekjet e ushtrisë për pastrimin e rrugëve, bllokoi gjithçka. Datat 15 dhe 16 Janar, ishin dy ditët më të rënda të jetës së tij. Merrte frymë me vështirësi, dhe humbi vetëdijen. Duke u gdhirë dita e 17 Janarit, zemra e tij pushoi së rrahuri. Marin Barleti, bashkëkohësi i tij, shkruan: "Skënderbeun e kujtojnë për gjithçka, për atë flasin të gjitha kontinentet. Sa herë Europa u gjend në prag-humbjen e lirisë, aq herë është shfaqur figura madhështore e kapëdanit shqiptar". Ato që ndodhën pas vdekjes së tij, janë të njohura nga Historia...

Topiajt. Familjet sundimtare shqiptare, ishin dhe funksionare të lartë në Perandorisë Bizantine. Heraldika si disiplinë e ka fillimin në Europë, në shek. e XI. Ajo merret me studimin e emblemave mesjetare dhe mbart identitet-historik-artistik dhe moral. Është përcaktuar si shkencë e njohjes. Kryetari i shtetit shqiptar, Skënderbeu ka pasur dy vula zyrtare, që kishin madhësi e simbole të ndryshme. Skënderbeu e përdori shqiponjën dykrenore edhe në vulën e tij të madhe. Shkresat zyrtare të Skënderbeut që njihen, kanë dyllin me gjurmën e vulosjes së tyre. Forma ishte rrethore e vulës zyrtare. Shqiponja dy krenore në qendër me yllin me gjashtë cepa, anash kishte rrethin me shkronja të mëdha: GEORGIVS CASTRIOTIVS SCENDARBIC.

Vula e vogël e Skënderbeut ishte skalitur në gurin e çmuar të unazës personale të tij. Ajo kishte formë tetëkëndëshe me përmasa maksimale 9 mm gjatësi dhe 7 mm gjerësi. Simbolet e saj ishin marrë nga mitologjia e lashtë pellazgjike. Tre libra të bibliotekës Kastriotase: "Libri të Uratave" (vitet 1480), "Librit të Petrarkës" (vitet 1465-1470) dhe "Codex Scanderbegus" i njohur ndryshe, si "Libri i Skënderbeut", flasin për gjurmët dhe ekzistencën e një biblioteke Kastriotase. Figura titanike e Heroit tonë Kombëtar mbetet përherë burim i fuqishëm shpirtëror i gjithë kombit. Emri i atdheut lartësohet nën shembullin e tij. Mbajtja gjallë e fuqizimi i ndjenjës së fisnikërisë dhe krenarisë kombëtare. Renditja përkrah popujve e qytetërimeve të tjera të përparuara që e kanë njohur dhe mbështetur historinë tonë. Respekt e mirënjohje për autorët, studiuesit e koleksionistët e huajt, që i kanë dhënë vendin e merituar heroit tonë kombëtar.

Alma Canaj

Ceremonia: Në batalionin Komando përfundoi kursi i tetë Komando Certifikohen 32 ushtarakë të FT për kursin funksional “Komando”

MAJOR NEXHBEDIN BASHA

Pas një stërvitje tre-mujore, më datë 20.01.2014, u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursit të tetë komando, kurs i cili përbën një risi në riaktivizimin e trupave komando në kurse profesionale. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, komandanti i Shkollës së Trupës, kolonel Agim Shahu, komandanti i batalionit të forcave speciale, n/kolonel Qazim Hoxha, efektiva të batalionit komando dhe kursantë të këtij kursi. Në fjalën e rastit komandanti i batalionit komando, n/kolonel Arben Hoxha, e konsideroi kursin komando, një ndër aktivitet kryesor të batalioni për vitin 2013 dhe si një domosdoshmëri për rritjen e kapaciteteve



operacionale të tij. Problematika e konstatuar gjatë zhvillimit të këtij kursi, vuri në dukje ai, do të jetë objekt i përmirësimit të punës për kurset në vazhdimësi që do të zhvillohen në këtë batalion gjatë vitit 2014. Komandanti i Shkollës së Trupës, kolonel Agim Shahu, përshëndeti pjesë-

marrësit edhe në emër të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Ai shprehu mirënjohje të veçantë për komandantin e Forcave Tokësore, Gjeneral Major Zyber Dushku, shtabin e FT-së, batalionin komando, batalionin special, të cilët gjatë vitit të kaluar kanë ofruar një

bashkëpunim të shkëlqyer me shkollën e trupës. “Në vlerësimin tim, - theksoi kolonel Shahu, - funksionimi i bashkëpunimit me komandën e Forcave Tokësore dhe reparteteve të kësaj force, përbën modelin e duhur të bashkëpunimit”. Në fjalën përshëndetëse, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, pasi falenderoi të pranishmit në ceremoni, në mënyrë të veçantë theksin e vuri tek rëndësia që ka kursi “Komando” për rritjen e aftësive profesionale të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve profesionistë si lider të stërvitjes, si dhe një “CV” për secilin kursantë për ecurinë në karrierë. Ndërkohë Ai, vlerësoi angazhimin e komandantit të batalionit, nënkolonel Hoxha, për konkretizimin e këtij projekti, si dhe komandantit të Shkollës së Trupës, kolonel Shahu, për mbështetjen e dhënë në procesin

mësimor. “Ju - theksoi gjeneral Dushku, kursantëve - u stërvitët në kushte të vështira të motit dhe terrenit, si ditën ashtu edhe natën, por me profesionalizmin dhe angazhimin e lartë dhe me devotshmëri, ju bëtë të mundur realizimin me sukses të këtij kursi, me një performancë dinjitoze dhe me rezultate të larta, për të cilat përgëzojë kursantët, komandantin dhe instruktorët e kursit”. Më pas theksin e vuri tek stërvitja e cila të vlerësohet jo vetëm si prioritet i përcaktuar në direktivën e MM dhe udhëzimet e SHSHP të FA-së, por si domosdoshmëri për realizimin e misionit dhe faktorë kryesor në arritjen e standarteve për zhvillimin e forcës profesionale. Ceremonia vijoi me shpërndarjen e certifikatave për 32 kursantë të kursit komando dhe u mbyll me një foto të përbashkët.

REPORTAZH

Trupat komando, elitë në konsolidim

Vitet lënë pas njëri tjetrin. Breza të tërë komando vijnë dhe ikën, secili lë gjurmë në librin e bardhë të historisë të kësaj strukture elite të Forcave të Armatosura. Me qindra të rinj dhe të reja, me dhjetëra komandantë repartit e nënrepartit kanë patur fatin të shërbejnë në trupat komando dhe të prekin realitetin e një ushtrie elitë, që ka nderuar kombin, Shqipërinë, duke u emetuar si një ndër dallëndyshet e para të angazhimit në mbështetje të paqes në botë, si në, Bosnje-Hercegovinë, Irak, Çad dhe Afganistan. Koha bën të sajën dikush nga ushtarët profesionistë lë ëndrrën pa realizuar për shkak të kontratës 6 vjeçare, disa dalin në reformë për mos ecuri në grade e karrierë, disa oficer, apo nënoficer emërohen në detyra të tjera dhe shërbejnë si këshillues në degë e drejtori, komanda forcash, në SHP të FA, MM, në shtabet e Aleancës, në Bruksel etj. Secili që ka dale nga dera e garnizonit “komando”, ka marrë me vete “armën” më të forte, dashurinë për profesionin e nderuar të ushtarakut, kalitjen e shpirtit të garës, disiplinën e fortë dhe të ndërgjegjshme, profesionalizmin për të shërbyer me devocion në çdo fushë të jetës. Mëngjesi i 20 janarit 2014, në ceremoninë e certifikimit të 32 komandove, pas përfundimit me sukses të Kursit Funksional Komando dha një mesazh të qarte, se; “të meritosh emrin komando nuk është e lehtë dhe për ta fituar këtë “titull”, duhet shumë punë, përgatitje, përkushtim dhe profesionalizëm. Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, ka



përshëndetur iniciativën e komandantit të batalionit nënkolonel Arben Hoxha dhe ka inkurajuar hapjen e kurseve të tjera, të kësaj natyre. Natyrisht, pohoi gjeneral Dushku, në zhvillimin e këtij kursi pati dhe vështirësi, kryesisht në mbështetje logjistike, por si nga komandanti i kursit kapiten Rexhep Nikolla, instruktorët dhe kursantët u arrit që të zhvillohet stërvitje cilësore, duke treguar profesionalizëm dhe standarde në kushtet e terrenit dhe motit, si për stërvitjet ditën dhe natën. Ky kurs theksoi gjenerali, do të jetë, pjesë e karrierës në “CV” e çdo kursanti. Ambient mjedisor në funksion të stërvitjes dhe argëtimit. Mirëmbajtjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit në Batalionin Komando, po i kushtohet një vëmendje e veçantë. Krijimi i një ambienti sa më funksional, me pemë dekorative, me sa më shumë ajër të pastër, është një ndër prioritet që ka komanda e këtij

batalioni. Nuk mjafton vetëm dita e caktuar e mjedisit, por çdo ditë në këtë repart jetohe me shqetësimin për t’u përkujdesur për ambientin që i rrethon në funksion të stërvitjes dhe çlodhjes. Brenda garnizonit janë krijuar kënde çlodhëse e argëtuese, të cilat ditat ditës po pasurohen me elemente të rinj, përfshi këtu edhe krijimin e lulishteve, hapësirave të gjelbra etj. Me këtë shqetësim jeton i gjithë efektivi kudo ku ai kryen detyra sipas funksionit organik. Stërvitjet në poligonet e stërvitjes, të qitjes, ne godinat ku realizohen skenarët për luftën në qendrat e banuara, etj, natyrisht prodhojnë edhe mbetje si gëzhoja, fishekësh pushke, pistoletë, mitrolozi, snajperi, e mbetje të tjera, por rezultat i të jetuarit çdo ditë me shqetësimin për mjedisin, është rritur ndërgjegjja, ndaj dhe secili pas përfundimit të qitjes, apo stërvitjes, secili individ merret me pastrimin e mjedisit që e rrethon.

Kursi funksional Komando, një risi dhe rikthim në traditë

Kursi “komando” ka qenë gjatë tremujorit të katërt të vitit të kaluar, epiqendra e veprimtarive kryesore që janë zhvilluar në Batalionin Komando. Kapiten Nikolla, komandant i këtij kursi tregon se kursantët kanë qenë të motivuar dhe nga njëra fazë në tjetrën kanë shfaqur performancë në rritje. Instruktori i taktikës, rreshter Elton Abasllari, tregon se me kursantët kemi zhvilluar stërvitje të natyrave të ndryshme, që u kanë shërbyer pjesëmarrësve për formimin si lider të stërvitjes. Mënyrat e kalimit të pengesave ujore, veprimet në prapavijë të kundërshtarit për asgjësimin e trupave armike dhe hedhja e tarzani në lartësi me pajimet dhe armatimin personal, kanë qenë disa temat që kemi zhvilluar. Hedhja e tarzani, tregon instruktori, ka një sprovë për komandot për nga shkalla e vështirësisë që mbart. Këndi i mbijetesës i batalionit është funksional. Në të janë zhvilluar nga instruktorët 15 elementë të krijimit të llojeve të zjarrit me mjete rrethanore, në një terren me kushte të vështira, me mungesë të ujit dhe ushqimit. Në këto orë mësimore tregojnë kursantët ne arritëm

në kohë të thatë të sigurojmë ujën nëpërmjet filtrimit. Edhe llojet e kurtheve për kafshët e egra ose si e thonë specialistët “gropa e dërrit”, kurthet me rrjetë maskimi, kanë qenë tema shumë interesante që kanë lënë bresa tek pjesëmarrësit. Programi tre mujor i stërvitjes i zhvilluar nga instruktorët rreshter Elton Abasllari i përgatitjes taktike, rreshter Mariglen Xhafa i përgatitjes fiziko-psiçike, kapiten Xhevdet Mesini i përgatitjes fizike dhe veprimet praktike, njohuri të përgjithshme mbi këto pajisje, lidhjet alpinistike dhe veprimet praktike, njohuri mbi urat alpinistike dhe ndërtimi i teleferikut, i shkallëve alpine, zbritjet nga kulla, veprime në shkëmb etj. Në këto ditë stërvitje temat : Lufta në qendrat e banuara, mënyrat e hyrjes në godinë, përgatitja fiziko-luftarake, vrapime 5 km, 8 km, 27 km me pajime, traversa 40 km, qitjet me armët e këmbësorisë me ngarkesa fizike, e shumë tema të tjera të programit, kanë rritur performancën e këtij kursi. Rreshter Mareglen Xhafa është instruktor i përgatitjes fiziko-psiçike. Ai shpjegon se kursantët kanë një rritje tepër të lartë të përgatitjes fizike, ngarkesë e cila nga njëra fazë në tjetrën vjen gjithnjë në rritje të cilën kursantët me motivimin që i karakterizon po përballojnë me sukses këto ngarkesa.

OPINIONE



Flet kolonel Agim Shahu, komandanti i Shkollës së Trupës

“Bashkëpunimit me komandën e FT, modeli i duhur i bashkëpunimit”

“Në vlerësimin tim, funksionimi e Forcave Tokësore dhe komandantët e reparteve të kësaj force, përbën modelin e duhur të bashkëpunimit. Baza e këtij bashkëpunimi, shprehet për gazetën “Ushtria” kolonel Shahu, nuk qëndron vetëm në detyrimet reciproke, të përcaktuara në procedurën standarde të veprimit të funksionimit të integruar të seksioneve/departamenteve të Shkollës së Trupës, me njësitë dhe repartet e FARSH, por edhe me mirëkuptimin e vazhdueshëm, sensin e ndihmës, mbështetjes dhe kujdesit të veçantë që Forca Tokësore ka treguar, ndaj funksionimit të strukturave arsimore të SHT, të atashuara pranë reparteve të kësaj force. Në këtë kuadër, shpreh mirënjohjen time për komandantin e Forcave Tokësore, gjeneralmajor Dushku, komandantin e batalionit komando, nënkolonel Hoxha dhe për të gjithë oficerët dhe nënoficerët e këtij batalioni, që me profesionalizmin e tyre të lartë, morën përgjegjësinë e plotë për zhvillimin e Kursit Funkcional, Komando, duke bërë më të mirën e mundshme në interes të realizimit me sukses të tij. Duke qenë se jam këtu në Zall-Herr dhe në këtë garnizon ndodhet edhe batalioni i Forcave Speciale, do vlerësoja bashkëpunimin dhe ndihmën e dhënë nga komandanti i batalionit nënkolonel Qazim Hoxha, për ndihmën e dhënë nga oficerët

e repartit të tij, në përgatitjen e programit mësimor për KAO, specialiteti “Zbulim”, si dhe për angazhimin e personelit oficer në mësimdhënie gjatë trajnimit të kursantëve të këtij kursi. Njëkohësisht do theksoja se përmes stërvitjes 12 javore, që u zhvillua në Batalionin Komando Zall, në Kursin Funkcional Komando, sa jam informuar nga vartësit e mi, që kanë asistuar, kursantët arritën të fitojnë dhe përmirësojnë më tej aftësitë dhe njohuritë bazë në lëndën e taktikës si mishërim i gjitha lëndëve të tjera të programit si; përgatitje zjarri, ku po bashkëpunojmë me komandantët e reparteve për të rritur numrin e qitjeve dhe sasinë e municionit për çdo qitës, lënda e topografisë, për orientimin në hartë dhe terren si ditën dhe natën, përgatitje fizike në të cilën u konkretizua me garën 27 km me sukses, alpinizmi, brezi i kalitjes, lufta në qendrat e banuara, të jetuarit në kushtet e stresit dhe të mbijetesës, etj, për të plotësuar më së miri rolin individual në operacione të ndryshme që kanë për mision “komandot”. Shpresoj dhe ju inkurajoj që aftësitë e fituara në këtë kurs ti përdorni me mjeshtëri dhe profesionalizëm në stërvitjet e ndryshme, duke rritur efektivitetin e grupit, skuadrës apo togës tuaj në mision. Shpreh bindjen time se aftësitë e fituara në këtë kurs, do t’i vini në shërbim të kryerjes së detyrave funksionale, duke rritur më tej efektivitetin operacional të repartit tuaj...”

Flet nënkolonel Arben Hoxha, komandant i Batalionit Komando

“Në 2014, edhe dy kurse të tjera komando”

“Kursi i 8-të “Komando”, i cili startoi në 27 dhjetor 2013 dhe përfundoi në 27 dhjetor 2013, shënoi rikthimin tek tradita e vjetër e kurseve komando, për rritjen e cilësive të stërvitjes si: në përgatitjen fizike, taktike dhe konsolidimin e elementëve në topografi dhe alpinizëm. Rihapja e tij ishte jo vetëm një risi midis të shkuarës dhe të tashmes, por në vetvete nënkuptonte dhe përbënte një detyrim për mua si drejtues dhe efektivat pjesë përbërëse e kësaj “trupe elitare”, pasi fjala elitë përbën në vetvete një sfidë për tu arritur dhe mbajtur në vazhdimësi. Kohëzgjatja e këtij kursi u planizua mbi bazën e zhvillimit të kurseve të mëparshme, ku u aktivizua Manuali i Stërvitjes së Ushtarit Komando, nga seksioni i operacioneve dhe stërvitjes të batalionit në bashkëpunim me Degën e Operacioneve dhe Stërvitjes të Forcës Tokësore, bashkëpunim i cili finalizoi një program stërvitjeje rezultativ për kursin komando. Me krenari, thekson nënkoloneli, ju jemi mirënjohës brezave të mëparshëm të cilët me kurajë dhe korrektësi hodhën themelet e ngritjes së emrit komando dhe padyshim një falenderim i veçantë i kushtohet ndihmës së pakursyer të Komandantit dhe Shtabit të Forcave Tokësore, si dhe instruktorëve të kursit VIII -të komando: kapiten Rexhep Nikolla, kapter Xhevdet Mezini, rreshter Elton Abasllari, rreshter Mariglen Xhafa. Ne, pohon nënkoloneli, në modelin e këtij

kursi, patëm një bazë, ku u mbështetëm dhe kjo i dedikohet si një falenderim i veçantë instruktorëve të Forcave të Amatosura turke, të cilët kanë patur një kontribut të veçantë dhe identifikim nga ana konceptuale në programin e stërvitjes, pa përmendur ndihmën logjistike. Problematika e konstatuar gjatë zhvillimit të kursit komando, do jetë objekt i përmirësimit të punës për kurset në vazhdimësi ku me një mbështetje më të mirë logjistike do përforcohen standartet e kërkuara. “Komando” sa e sa breza ushtarakësh kanë shërbyer me korrektësi dhe profesionalizëm nën beretën blu, në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në emergjencat civile në ndihmë të komunitetit, si dhe në stërvitjet e ndryshme, duke lartësuar në vazhdimësi simbolin e trupave komando...” Për vitin 2014, shprehet Komandanti i Batalionit nënkolonel Hoxha, prirjet është rritja e cilësisë së stërvitjes, trajnimit dhe vlerësimit sipas standardeve. Gjithashtu po gjatë vitit do të hapen edhe dy kurse të tjera komando, ku nëpërmjet këtij lloji trajnimit do të rritet kualiteti i komandove dhe numri i liderëve të stërvitjes dhe njëkohësisht do të rriten kapacitetet operacionale të batalionit. Ky kurs, do jetë selektin, duke përthithur vlerat më të mira dhe që premtojnë për karrierë të suksesshme në të ardhmen. Mjedisi, sikurse vuri detyrë gjeneral Dushku, nga ana jonë do të shihet i pa ndarë nga disiplina, stërvitja dhe përmirësimi i kushteve të stërvitjes dhe jetesës...”

Flet kapiten Rexhep Nikolli, komandanti i kursit funksional “Komando”

“Një eksperiencë me vlerë për përgatitjen e liderëve të stërvitjes”

Kapiten Rexhep Nikolla, nuk e fsheh kënaqësinë dhe emocionin që i dhuruan kursantët me rastin e përfundimit me rezultate të larta të Kursit Funkcional Komando. Ai shpjegon se trupat komando janë shquar për tregues të mirë. Ky kurs nuk është i pari pasi 7 -të të tillë janë kryer deri tani, një pjesë e të cilëve edhe nga instruktorë turq. Por, ajo që dua të theksoj është se ne arritëm që me instruktorët tanë të zhvillojmë në mënyrë cilësore të gjitha disiplinat sipas një programi stërvitorë të miratuar edhe nga Komanda e Batalionit dhe Shkolla e Trupës. Theksoj se rezultatet nga njëra fazë në tjetrën erdhën në ngjitje, po ashtu edhe ngarkesa fizike dhe psikologjike. Ndaj në fund të testimit ku asistuan edhe specialist nga Shkolla e Trupës, kursi u vlerësua me nota pozitive. Në mbarëvajtjen e kursit, kemi pasur edhe mbështetjen e vazhdueshme të komandantit të batalionit, nënkolonel Arben Hoxha, shefit të shtabit, kapiten Pëllumb Hidri, shefit të operacioneve dhe stërvitjes, major Albert Doçi, psikologes së batalionit Manjola Kondili dhe stafit të batalionit. Kjo eksperiencë e fituar është filmuar dhe fotografuar, për të mbetur si një

eksperiencë për brezat. Do veçoja për rezultate më të larta kursantët, nëntoger Leart Myrto, nëntoger Elton Kupe, nëntetar Arjan Guri, Pr.2 Besim Basha, e shumë të tjerë. Në përfundim të kursit u arrit të certifikohen 32 oficerë, nënoficerë dhe ushtarë profesionistë. Gjatë periudhës 3 mujore të stërvitjes dhe trajnimit, ndonëse jemi përballur me vështirësi të terrenit, motit dhe mungesës logjistike ne ja arritëm ta përfundojmë ata me sukses. Programi teorik me atë praktik u ndërthurën, ku përqindja më e madhe ka qenë veprimet në terren si marshime të gjata, vrapime nga 3, 5, 8, km duke e rritur nga njëra fazë në tjetrën në finalizimin deri në 27 km. Po ashtu kemi zhvilluar edhe marshimin me pajime 40 km, me ngarkesa mbi 27 kg me variante taktike, kalim pengesash ujore, në itinerarin Zall-Herr-Mali i Dajtit-Feken e kthim. Mund të pohoj se ky kurs ka qenë më të vërtetë i lodhshëm, por nga kjo eksperiencë nuk mësuam vetëm kursantët, por edhe drejtuesit e instruktorët, të cilët me metodikën e përdorur ja arritën të asimilohet më një performancë dinjitoze programi stërvitorë.

“Striking Eagles 4”, fundi i një etape dhe nisja e një rruge të re

Nga: Nënkolonel LEONARD ZHUPA
Komandant i MAT ALB-US
“Striking Eagles”

Këto ditë të janarit, ekipi shqiptaro amerikan MAT 4, është në detyrë me të gjithë motorët e ndezur, kjo sepse me ndërrimin e viteve, misioni i MAT 4 ndryshoi, nga këshillim në nivel batalioni kaluam në këshillim në nivel brigade. Ne datën 1 janar, morëm përsipër zyrtarisht misionin për këshillimin dhe ndihmën për Brigadën e 1-rë MFS (Mobile Strike Force) afgane. Për shkak të nivelit dhe të strukturës së re, puna e parë që bëmë në bashkëpunim dhe me oficerin ekzekutiv major Murphy dhe me këshilltarin për nënoficerët të komandantit të Kontingjentit kapter Eric Maney, ishte organizimi i grupit për detyrën e re, ku u morën parasysh si pikat e forta ashtu edhe ato të dobëta brenda grupit, duke qenë se vinim mbas një periudhe gjashtë mujore këshillimi dhe ndihme. Do të desha fillimisht tu tregoj për rrugën dhe ecurinë e deritanishme të ekipit të MAT 4, që mund ta quaj se ishte një rrugë e mbushur me sfida të shumta. Duke filluar, për arsye të angazhimeve të palës amerikane, për stërvitjet e detyrueshme paradislouese që zhvillohen në USA, si dhe kohëndarjes për zhvillimin e stërvitjes së detyrueshme për misionet MAT, Nato Phase-2 që zhvillohet në Hohenfels Gjermani, nuk patëm mundësi që të dyja palët e grupit, të kishim kohë të njiheshim dhe të ndërtonim kohezionin e nevojshëm të grupit. Pra, sfida e pare, ishte njohja dhe ndërtimi i kohezionit të grupit, ku si grup i plotë u bëmë vetëm me mbërritjen në teatrin luftarak në Afganistan. Përsa i përket palës tonë, në përgjithësi nuk isha shumë i shqetësuar. Në përbërje të ekipit kisha n/kolonel Qazim Hoxhën me përvojë në batalionin special dhe J5 në SHP, kapiten Alban Kurtin dhe toger Ermal Nakon nga batalioni i forcave speciale, major Nesti Kuqin dhe kapiten Arsen Bitrin nga Agjensia e Inteligjencës së Mbrojtjes, kapiten Ervin Hodo dhe kapter Gazmor Belishta nga ASNI, kapiten Eduart Kaloshin dhe tetar Bledar Blacëri nga AME, toger Filjon Caushin nga Brigada Logjistike dhe toger Jonian Shkëlqimin, nga Regjimenti i Mbështetjes. Një nga kërkesat në përzgjedhjen e personelit MAT, është të kenë eksperiencë në misionet të tilla, gjë që shumica e efektivit e kishte. Nëse me pjesën tone, patëm kohë të konsolidonim grupin, gjatë fazës së parë paradislouese, që zhvillohet në Shqipëri, me palën amerikane, takimin e pare, e patëm vetëm në javën e dytë të qershorit 2013, kur mbas javës së parë ku u trajnuam për ngjarjen e makinave MaxPro, filluam së bashku në javën e dytë të Qershorit, me njohje dhe familjarizim me armët që kishim në përdorim në mision, qoftë armët personale ashtu dhe armët kolektive si M249 dhe 50 cal si dhe M19, po kështu dhe pala amerikane e grupit u njoh dhe zhvilloi qitje me armët tona. Në vazhdim, do të fillonim stërvitjen NATO Phase 2 paradislouese, ku përsëri një pjesë e ameri-



kaneve, ishin të detyruar të dislokohehin si detachment i përparuar para pjesës tjetër të grupit. Gjithsesi, shqetësimi për ndërtimin e frymës së grupit, zvogëlohej kur mendoja se nuk ishte bashkëpunimi i parë me palën amerikane, mirënjohja dhe respekti që kemi për ta, kisha besim dhe theksova te pala jonë veprimin profesional, si një element thelbësor për ndërtimin e marrëdhënieve të duhura, për përmbushjen me sukses të misionit të marrë. Asnjëherë, nuk e hoqa nga mendja, se përveç misionit kryesor, atë të ndihmës e këshillimit për batalionin afgan, me qëllim krijimin e lidhjeve për t'i ofruar partnerëve afganë, mbështetje me asetet e koalicionit në ato fusha, ku ato nuk i kanë ngritur ende, ose janë duke i ngritur, për të mbështetur në planizimin operacional dhe kryerjen e operacioneve, për të mundësuar ndërtimin e një batalioni afgan të qëndrueshëm, profesional dhe kompetent, ashtu kemi dhe një mision tjetër, po aq të rëndësishëm për forcimin e marrëdhënieve si me palën afgane, ashtu dhe me palën amerikane duke shprehur kështu vendosmërinë për fuqizimin e aleancës ndërmjet vendeve tona. Kur punoj me kolegët amerikanë, më kujtohen dy vite që përfundojnë me numrin nëntë, 1919 dhe 1999, dy vite domethënëse që kombi amerikan ka ndihmuar vendosmërisht kombin shqiptar. Vetë natyra e misionit që kishim marrë përsipër, nuk të lë shkas të kesh një alternativë të dytë, grupi duhet të kishte koherencën e duhur, bashkëpunimi dhe ndërlidhja janë të vetmet metoda që minimizojnë rrezikun në misionet të tilla, ku siç dihet rreziku kryesor dhe arma e zgjedhur e armiqve për të thyer vullnetin e koalicionit janë sulmet e brendshme, që njiheshin me termin “green on blue”, i zëvendësuar me termin më gjithëpërfshirës “Insider threat.” Të gjithë duhet të shkëmbehem, kur dikush brenda grupit komunikonte me partnerët afganë dhe kryente detyrën e këshillimit tjetri duhet të bënte Ëngjëllin Mbrojtës. Një element i rëndësishëm për minimizimin e rrezikut është komunikimi, qoftë kur

një nga nëngrupet vëren diçka që nuk shkon dhe duhet të lajmërojë nëngrupet e tjera, ose dhe në rast të një sulmi përsëri për të lajmëruar vendndodhjen e incidentit, dhënien e ndihmës së parë dhe largimin e të gjithë grupit nga zona e rrezikut. Mënyra më e mire, për të minimizuar rrezikun, është komunikimi nëpërmjet telefonisë celulare, sepse është më pak dyshues te partnerët afganë, dhe më pak komprometues se radio e dorës dhe ndoshta më i sigurtë për momentin. Vonesa e fondeve, për komunikim nga ana e Forcës Tokësore, na vuri në vështirësi dhe mendoj se duhet të rishikojmë urdhrat dhe udhëzimet për shpenzimet telefonike, si dhe shpenzime të tjera operationale, që t'i përshtaten situatës reale në teatrin luftarak. Nuk mund të trajtohen njësoj si Shqipëri, ashtu dhe njerëzit që janë me mision luftarak. Nëse diçka në atdhe pret, këtu në teatrin luftarak, çfarëdolloj detyrë të kesh puna nuk pret, sepse ka të bëjë me ruajtjen e forcave.

Që në fillim vendosa të drejtoja me metodën e komandimit me mision, e cila u jep hapësira vartësve për të patur iniciativë për kryerjen e detyrave dhe misionit. Kjo, duke qenë se ndoshta nuk është shumë e zhvilluar tek ne, ndoshta dhe nuk u kuptua mirë tek një pjesë e efektivit në fillim. Gjatë drejtimit të mbledhjeve nga XO, dukej sikur isha i shkëputur dhe ja kisha lënë në dorë gjithçka pjesës amerikane, dhe ne nëse nuk e shohim diçka me sy bëhemi mosbesues. Por gjithsesi duke qenë shumë i bindur në profesionalizmin e palës tonë dhe padyshim dhe të palës amerikane, e ndieja që nuk do të zhgënjehesha. Grupi krijoi kohezionin e duhur, brenda një kohe shumë të shkurtër. Një faktor tjetër që ndikoi në ndërtimin dhe ruajtjen e kohezionit të grupit ishte dhe ndërtimi i një programi javor stërvitje për përsëritjen e rifiksim e procedurave standarde të veprimit (SOP), për t'iu përshtatur ndryshimit të situatës në Afganistan, si dhe kryerja e çdo veprimi së bashku, ashtu si misionet dhe detyrat e tjera të

përditshme. Ky ndryshim situatë, do të jetë për mendimin tim, një nga sfidat që do të ketë MAT 5, i cili do të na zëvendësojë në muajin mars. Forcat e koalicionit janë duke u reduktuar nga dita në ditë, dhe me reduktimin e tyre, reduktohen dhe asetet që ato ofronin dhe që janë thelbësore për misionin si MEDEVAC dhe mbështetja me zjarr nga afër nga ajri CAS, si dhe situatë e nxehtë e pritshme për shkak të zgjedhjeve presidenciale në Afganistan. Së bashku me major Murphy, punën e ndërtuam mbi veprime konkrete, duke vazhduar në brazdat e vendosura nga ekipet OMLT dhe MAT të mëparshme, por edhe duke bërë rregullimet e nevojshme, për t'iu përshtatur përbërjes së grupit tonë, i cili dhe u reduktua nga 32 në 24, duke qenë gjithmonë në kërkim të metodave të reja për të përmirësuar situatën dhe realizimin e misionit. Sukses i realizimit në ndërtimin e marrëdhënieve të besimit reciprok. Nëse nuk je në gjendje të ndërtohet marrëdhënie me partnerët afganë, atëherë ti do të jesh si një i jashtëm që nuk e merr vesh kurrë se cilat janë pikat e dobëta dhe të forta të tyre, në cilat pika ose fusha kanë nevojë realisht për ndihmën dhe këshillën tënde. Mund ta quaj një sfidë tjetër, sepse mungesa e fondeve financiare na vuri në vështirësi, sepse nuk ishim në gjendje të organizonim, asnjë lloj aktiviteti që të na ndihmonte në këtë drejtim. Misioni i MAT për rastin tone, është si të thuash i mbështetur në tre shtylla që duan kujdesin e nevojshëm:

- e para, grupi jonë i këshillimit, i cili është i përbërë nga dy pjesë shqiptare dhe amerikane që kërkon vëmendjen e duhur për ta bërë një trup të vetëm
- shtylla e dytë e cila është pala partnere afgane, e cila ka një përzjerje të shumëllojshme, ku gjen oficerë me formim të rregullt ushtarak lindor (shkollat ushtarake të sistemit rus), oficerë të ardhur nga radhët e muxhahidinëve që kanë luftuar kundër rusëve dhe një brez i ri i kualifikuar në përdorim ose në Kinë e Indi - shtylla e tretë grupi i përkthyesve, jo më

pak i rëndësishëm se dy të tjerët, që me të drejtë hyn te asetet thelbësore të misionit. Duke marrë shkas nga e treta, desha të rithekoj dhe njëherë rëndësinë që duhet të ketë pjesëmarrja në ekip e dikujt që di sadopak gjuhën afgane. Duke patur një person të tillë në grup, je në gjendje të përcaktosh nivelin e përkthimit dhe të përcimit të informacionit te partnerët, duke realizuar caktimin e përkthyesve më të mire, për probleme delikate. Këtu do të veçoja kapiten Hodon, i cili me njohuritë e tij në Pashtu, krijoi një atmosferë miqësore, qoftë në Kandak, qoftë në të gjithë territorin e Divizionit 111, ku na duhej të lëviznim në këmbë. Përsa i përket këshillimit dhe ndihmës vazhduam të zhvillonim takime të përditshme, me partnerët afganë, u përqendruam në zhvillimin e kurseve të ndryshme si të kompjuterit, procedurave të komunikimit, kurseve të ndryshme xheniere, si me xhenierët e MAT 4, ashtu dhe duke shfrytëzuar asetet e tjera të kontraktorëve të koalicionit në Afganistan, kurse për njohjen e armëve dhe detyrave të kompanive të rikonicionit, kurse për ngjarjen e mjeteve, kurse të ndihmës së parë në fushë të luftimit, etj, të gjitha këto me metodën “Trajno trajnuesin.” Do të veçoja këtu dhe dy arritje të rëndësishme, në fushën e inteligjencës dhe atë logjistike, e cila rezultoi me një Loya Jirga në secilën fushë. Fillimisht duke parë mangësitë në grumbullimin dhe përpunimin e informacionit, nga ana e këshilltarëve të S2, kapiten Arsen Bitri dhe Warrant officer Robinson, u organizua Loya Jirga, ku u ftuan dhe morën pjesë efektiva, jo vetëm nga batalioni jonë, por edhe pjesëtarë të inteligjencës të Brigadës, divizionit, njësitë të tjera afgane dhe të koalicionit në afërsi të kampit Blackhorse, ku vepronte MAT 4. Nga kjo, u arrit një sukses i konsiderueshëm, ku u vendosën takime dhe mënyra shkëmbimi informacioni në baza të rregullta. Nisur nga sukcesi i S2, duke qenë se sistemi i furnizimit kishte problem, e njëjta praktikë u ndoq edhe me S4. U organizua nga ana e MAT 4 një

Loya Jirga tjetër, me pjesëmarrjen e këshilltarëve Portugezë të divizionit, turq të Brigadës etj, dhe mund tu them se këshilltarët tanë të S4, toger Tomasini dhe toger Nako e XO ,major Murphy, e njohin sistemin e furnizimit logjistik, si atë afgan dhe atë të koalicionit më mirë se të tjerët, duke ju ofruar partnerëve informacion shumë të dobishëm, për të vënë në lëvizje sistemin. I vetmi merak, që ndoshta nuk e realizuam plotësisht, ishte që të bënim më tepër për baterinë e artilerisë, por nuk mundëm ta lëviznim nga detyra në pika kontrolli, që kishte marrë prej muajsh, që janë të pranueshme për situatën në Afganistan. Megjithëse ishte një batalion i mbështetjes së luftimit, kryesisht përdorej për misionet e sigurie gjithandej, brenda Kabulit dhe ishte një batalion që Komandanti i divizionit dhe ai i Brigadës kishin besim. Një nga detyrat kryesore të misionit tonë, është ndihma që duhet të jepnim në procesin e planizimit dhe gjatë kryerjes së operacioneve luftarake. Gjatë gjithë kohës, deri në nëntor batalioni kryente vetëm misionet e sigurie, me pika kontrolli të shumta derisa do të vinim tek muaji Nëntor kur Kolonel Resuli, komandanti i batalionit, një muxhahidin me përvojë të gjatë luftarake, na tha se kishin marrë një detyrë rrethim kërkimi, ku do të merrte pjesë e gjithë brigada dhe një rol kryesor kishte dhe batalioni jonë. Sigurisht, duke u konsultuar me major Murphy, menduam që ky ishte një rast shumë i mirë për të ndihmuar dhe vëzhguar dhe vlerësuar nga afër, se si batalioni kryente detyra të tilla. Për shkak të kohës së paktë në dispozicion, kryem një planizim të shpejtë të ndarë në dy faza, ditën e parë asistua baterinë e artilerisë në vendosjen e dy topave 122 mm, për mbështetje me zjarr të operacionit, dhe ditën e dytë vendosëm të vizitonim trupat në kryerjen e detyrës. Nga informacioni që kishim pika na mund të shkonim me mjete, ishte një pikë në qafë të malit, ku ushtria afgane kishte një pikë vrojtimi, e cila i përkiste kompanisë së rikonicionit të batalionit tonë (një pjesë e rrugës mund të bëhej, me makinat tona dhe një pjesë me rejnsherat afgane, pasi rruga ishte shumë e ngushtë dhe me kthesa me rreze shumë të vogël). Prej andej, duhet të ecnim në këmbë, një orë për të zbritur tatëpjetë dhe dy orë për tu ngjitur përpjetë. Aty takuam dhe patëm një bisedë të gjatë, edhe me komandantin e Brigadës gjeneral Noor, dhe kur erdhi ora për të nisur operacionin, pamë një hezitim të vogël nga ana e tyre për të na lejuar të zbrisnim poshtë, por ne ishim të vendosur të vazhdonim. Në fakt kishte qenë

më e vështirë se sa na kishin thënë, e para sepse batalioni ishte zhvendosur për të qenë më pranë objektivit, e dyta rruga ishte shumë e tatëpjetë, dhe e treta pesha e rëndë që kishim me vete, antiplumbat, municioni shumë dhe pajisje të tjera për komunikim dhe mbrojtje. Kjo më bëri që mbas dy orësh udhëtim, duke llogaritur rrugën e kthimit, të kisha një dilemë: të vazhdonim misionin apo të ktheheshim mbrapsht. Gjithsesi vendosëm të vazhdonim misionin dhe mbas pak, ajo për të cilën sakrifikuam, u bë realitet. Në një majë kodre u shfaq Kolonel Resuli, i cili duke na buzëqeshur, na falenderoi që ishim pranë tij, mori hartën dhe filloi të na shpjegojë si po zhvillohej operacioni, rolin që kishte patur batalioni, veprimet që kishte kryer deri në atë kohë, duke na lënë të kuptojmë se mundimi nuk na shkoi kot. Mbasi përfunduam dhe pushuam pak, morëm rrugën e kthimit, duke e ditur se na priste një ngjije e vështirë, e cila na mori mbi katër orë për të arritur në pikën e vrojtimit në qafë, ku me rejnsherat e batalionit zbritëm poshtë për të pushuar në pikën e bazimit deri në mëngjes, për tu kthyer më pas në Kamp Blackhorse. Të gjithë e ndjejmë lodhjen, por toger Jonian Shkëlqimi dhe përkthyesi Daidullah që kishim me vete nuk donin t'ia dinin dhe mbërritën të parët në qafë. Mbasi kësaj vërejtëm se partnerët afganë, na shikonin me një sy tjetër me më tepër respekt, si dhe ishin më të hapur dhe shoqërorë më ne. Për fat të keq, atë ditë humba dhe një telefonatë që ministria e Mbrojtjes bëri nga Brukseli. Këtu operacionet në Afganistan zhvillohen në bazë të doktrinës COIN, një element i rëndësishëm i të cilës është KLE (Key Leader Engagement), komunikimi me liderët kryesorë për të fituar zemrat dhe mendjet. Në bashkëpunim me Task Forcën TARPON, vazhduam pjesëmarrjen në një projekt ndërtimi shkollë në Tangi Kalay, zonë e cila nuk ishte miqësore me forcat e koalicionit, ku ne si MAT 4 u përqendruam në kryerjen e operacioneve të sigurimit të zonës me kompaninë e rikonicionit, të drejtuar nga një oficer i shkëlqyer afgan, Kapiten Ibrahim, si dhe të këshilluar nga toger Tomasini, kapiten Alban Kurti të cilin dua ta veçoj për shpirtin e lartë ushtarak, megjithëse me ndërhyrje të shumta mjekësore në trup nuk u ankua kurrë. Paralel me këtë u punua që shtabi i batalionit, të krijonte lidhje dhe të mundësonte angazhimin e liderëve kryesorë, e cila u bë e mundur duke marrë me vete jo vetëm kompaninë e rikonicionit për sigurimin e zonës, por edhe

oficerë të tjerë të shtabit të batalionit. Në interes të kësaj u krye dhe një operacion tjetër i formës POO (Point Of Origin), prezencë në pikën e origjinës, për të kontrolluar një zonë nga e cila goditej kampi, si dhe për të treguar prezencën e ushtrisë afgane, në këtë zonë, për tu thënë talebanëve se ne jemi këtu dhe do tu gjejmë. Gjatë gjithë kësaj periudhe bashkëpunimi me palën amerikane, ka qenë jashtëzakonisht i frytshëm dhe profesional. Në kuadër të kësaj, do të veçoja ndihmën që na dhanë pjesa amerikane e ekipit për të mundësuar marrjen pjesë gjyqin kundër personave, që qëlluan kapiten Feti Voglin. Koha që kishim në dispozicion, ishte shumë e pakët dhe fillimisht mendova se nuk do të mundnim ta merrnim lejen, për të lëvizur. Mbasi i komunikova major Murphy, për detyrën që kishim marrë nga SHP, dhe rëndësinë e saj, qoftë shtetërore, qoftë dhe personale duke qenë se kam mbi nëntë vjet që punoj në batalionin e forcave speciale, përsëri isha në mëdyshje, sepse ishim jashtë çdo limiti për të marrë lejen e lëvizjes. Gjysmë ore më vonë më njoftoi se e kishte marrë lejen nga Task Forca TARPON, që monitoron dhe mbështet lëvizjet tona dhe do të lëviznim të nesërmen në mëngjes drejt Bagramit, në afërsi të së cilit ishin dhe ambientet e gjykatës Afgane. Dua të falenderoj pjesën e amerikane të ekipit, të cilët vendosën veten në rrezik në një mision të rëndësishëm shqiptar, sepse lëvizja në orët e para të mëngjesit, kur nuk ka lëvizje të popullsisë civile, është shumë më e rrezikshme se lëvizja në orët e tjera.

Përveç detyrës kryesore që kryem me batalionin afgan, MAT 4 ishte një element shumë i rëndësishëm i Kampit Blackhorse, i cili kishte detyra konkrete, qoftë për mbrojtjen e kampit në rast sulmi nga jashtë, sigurimin e zonës së uljes së helikopterit, detyrë të cilën e kryem konkretisht kur një nga rojet e ruajtjes së kampit u plagos nga një predhë 107 mm, si dhe deri në fund të Dhjetorit, kur në kamp ngelëm vetëm MAT 4 dhe një grup shumë i vogël ushtarakësh amerikanë, të cilët i dorëzuan kampin ushtrisë afgane. Po kështu ekipi i MAT 4, mori pjesë aktive në jetën kulturore-sportive të kampit Blackhorse, duke fituar çmime të ndryshme si në volejball, futboll, bilardo etj. Në volejball u mblodhën lojtarë të gjatë nga shtete të ndryshme, për të na mundur duke krijuar një atmosferë shumë të këndshme. Duke vlerësuar performancën tonë, komandanti i Kampit Blackhorse n/kolonel James Lake, i dha ekipit të MAT 4, një certifikatë

vlerësimi. Misioni MAT, është një nga kontributet më domethënëse, që një shtet mund të ofrojë për shkallën aktuale të zhvillimit të operacionit të ISAF në Afganistan. Është një eksperiencë, që i ka të gjitha brenda, si punën në shtab për ndihmë dhe asistencë ashtu dhe veprimet ndoshta të një ushtari të thjeshtë, sepse oficeri dhe nënoficeri gjatë operacioneve të ndryshme, do t'i duhet të bëjë shoferin, mitraljerin në kullën e makinës, komandantin e makinës dhe detyra të tjera, të cilat zhvillohen në një nivel të lartë rreziku dhe kërkojnë një përqendrim të lartë. Përveç detyrës kryesore, çdonjëri ka një ose dy detyra shtesë. Duke qenë një mision më i gjatë se të tjerët, kërkon dhe një kujdes më të lartë për shëndetin fizik dhe mendor të efektivit, e cila është një temë për të cilën në ushtrinë tonë, duhet të punohet më seriozisht. Ka pika mbështetje që shkruhen dhe në urdhër të MM por, janë të pazbatueshme, ose nuk kanë udhëzime të qarta se ku, kur çfarë dhe si mund të veprohet. Qenia në mision ka një dinamikë më të lartë dhe kërkon vendimmarrje në kohën e duhur. Nisur nga eksperiencia, e cila zbatohet këtu mendoj se zhvillimi i VTC (me video ose me telefon), do ta ndihmonte shumë punën e komandantit të misionit dhe do të ulte rrezikun për trupat në mision. Pra, siç e thashë dhe më lart, jemi me motorë të ndezur për të përballuar sfidën e radhës, këshillimin në rang brigade, e quaj sfidë sepse ekipi është formatuar për të këshilluar në nivel batalioni. Megjithëse patëm vështirësi për të mësuar se cili do të ishte misioni ynë i ri, edhe ky mund të jetë një mësim i nxjerrë, komunikimi ndërmjet personave të lidhur me këtë mision, ndoshta nëpërmjet VTC, ose thjesht një telekonferencë nëpërmjet telefonit, ku përfaqësuesit tanë në SHAPE, NATO, J3 dhe degët e tjera në SHP, Komandanti MAT 4 dhe MAT 5 etj të jenë prezent. Mbasi e saktësuam cili do të ishte misioni i ri, krahas vazhdimit të këshillimit të batalionit filluam të mbledhim të dhëna e informacion për detyrën e re dhe të njihemi me problemet dhe shqetësimet, që kishte për t'i paraprirë detyrës së re. Të ndihmuar nga kolegët kanadezë, të cilët kishin këshilluar një nga batalionet më parë, realizuam një takim me Komandantin e Shtabit e Brigadës 1 MFS, i cili na priti shumë mirë dhe na kërkoi të fillonim menjëherë nga puna. Duke qenë se janë reparte të reja në krijim e sipër, kërkojnë një bashkëpunim të lartë nëpërmjet Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë afgane, Brigadës dhe aseteve të koalicionit që përgjigjen për kompletimin, stërvitjen, pajisjen dhe dislokimin e batalioneve. Po kështu, një ndihmë të madhe na dhanë dhe kolegët amerikanë, me në krye n/kolonel Ballagh që këshillojnë prej disa muajsh Brigadën e dytë MFS, me të cilët kemi planifikuar dhe një vizitë në bazën e tyre në Kandahar, për shkëmbim eksperiencë dhe sinkronizuar përpjekjet, si dhe për të parë mundësitë e përbashkëta, për zgjidhjen e problemeve të partnerëve afganë dhe realizimin me sukses të misionit që kemi. Për fat të keq Brigada, nuk do të ketë këshilltarë në nivel batalioni, kështu që do të punojmë me të dyja metodat e këshillimit, këshillimin paralel, ashtu dhe atë vertikal, për të shkuar herë pas here te batalionet, për të parë nga afër problemet që kanë, për të krijuar dhe mundësuar lidhjet e nevojshme ndërmjet batalioneve dhe divizioneve, që i kanë, ose do i kenë në përfundim. Do të dua t'i përmend të gjithë për kontributin e tyre, në mbarëvajtjen e misionit, duke filluar nga major Murphy një oficer model, që i

parapriu ndërtimit të punës për misionin e ri, Kapiten Eric Maney për seriozitetin dhe menaxhimin perfekt të përkthyesve, n/kolonel Qazim Hoxhën për organizimin dhe eksperiencën e punës në shtab, kapiten Evin Hodo i cili përveç kryerjes detyrës funksionale dhe për kryesimin në celuloide të të gjithë veprimtarisë së MAT 4, kapiten Arsen Bitri dhe Warrant Officer Preston Robinson, për profesionalizmin e mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së informacionit, toger Ermal Nako dhe kapiteni amerikan D.W Janszky, për mbështetjen logjistike, jo vetëm të kontingjentit, por edhe për koordinimin e punës tek njësi afgane, të cilën këshilluan, aktualisht i ndihmuar nga Toger karizmatik dhe i palodhur Aaron Tomasini. Major Nesti Kuqi dhe ndihmësi i tij kapiten Gazmor Belishta, të cilët me përkushtimin dhe profesionalizmin siguruan ndërlidhje të pandërprerë me SHPFA. Dyshtja profesionale e xhenierëve shqiptarë kapiten Kaloshi dhe tetar Blaceri dhe homologu i tyre amerikan kapiten Kristian Del Rosario, të cilët do të ishin në ballë të punës, jo vetëm për këshillimin e palës afgane, por edhe gjatë periudhës së zhvendosjes së Qendrës Operacionale. Këshilltarët e artilerisë, të drejtuar nga Toger Mark Lim, një djalë shumë punëtor dhe shoqëror, i ndihmuar nga Toger i ri dhe premtues Jonian Shkëlqimi, i cili, megjithëse nuk ishte një artiljer i mirëfilltë, arriti shumë shpejt të përshtatej me grupin dhe të bëhej i dobishëm. Pjesë e këtij grupi, ishte edhe Rreshteri Daniel Wilfong, i cili u dallua veçanërisht për orët jashtëzakonisht të dobishme, të mësimave treguese, për tema të ndryshme të mirëmbajtjes dhe nxjerrjes nga zona e rrezikshme të makinave. Me humorin e tij ai pati një ndikim pozitiv, në atmosferën e përgjithshme të grupit. Me misionin e ri që grupi ka marrë përsipër të realizojë në Brigadën "Forca Goditëse e Lëvizshme", rreshteri Daniel Wilfong, është duke bashkëpunuar dhe kryer një punë shumë të mirë, me toger Filjon Caushin. Toger që në pamjen e parë, të duket jo shumë premtues, arriti që gjatë gjithë misionit, të tregonte aftësi shumë të mira profesionale, duke organizuar disa kurse për shoferët e ushtrisë afgane. Gjithashtu ai u dallua për aftësitë e tij shumë të mira, edhe në drejtimin e mjeteve taktike MAXPRO. Nuk mund të lë pa përmendur këtu kapitenin William Carroll dhe n/tetarin Christopher Anicito si dhe tetarin Mathew Manfredi, të cilët me dijet dhe përkushtimin e tyre në këshillimin e Kompanisë së Shtabit të batalionit afgan (tashmë të Brigadës), do të bënin që efektivat e këtyre njësive, të ngriheshin në një nivel të lartë profesional. Dhe së fundmi, por jo i fundit për nga rëndësia ngelet kapiteni Daniel Coleman. Ai do të ishte instruktori, miku shumë i mirë i të gjithë shqiptarëve, një djalë tepër i veçantë, i cili karakterizohet nga fjalët e pakta dhe puna e shumtë dhe cilësore.

Misionin të MAT "Striking Eagle", duket se po i vjen fundi. Së shpejti, ne largohemi nga kjo tokë me bindjen dhe besimin e plotë, se vazhduam dhe mbyllëm një punë të mirë të kolegëve paraardhës të kontingjenteve MAT, në drejtim të këshillimit të batalionit të IV afgan. Koha dhe situata, kërkoi prej nesh të ishim të parët, që do të nisnim punën me një njësi shumë të rëndësishme siç janë Forcat e Lëvizshme Goditëse të Ushtrisë Kombëtare Afgane. Me punën e bërë deri tani, ne besojmë se e kemi justifikuar besimin që populli, qeveria dhe eprorët tanë në MM dhe SHPFA patën dhe kanë tek ne.



Logjistika, jetësimi i Direktivës së Mbrojtjes, angazhim i tërë efektivitetit



BASHKIM MALE

Në Brigadën Logjistike prej dy javësh vazhdon diskutimi, zërtimi dhe mënyra e implementimit të objektivave dhe prioriteteve kryesore të vitit 2014 në kuadër të Direktivës së Mbrojtjes. Ajo që quhet jetësimi i Direktivave të Mbrojtjes ka filluar më njohjen e tyre nga komandanti i Brigadës Logjistike, gjeneralbrigade Syrja Gjoka me tërë shefat e shërbimeve të kësaj njësie dhe me tërë komandantët e reparteve. Theksi kryesor u vu në kërkesën e ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli që të detajohen në plane dhe programe veprimi dhe zbatimi të gjitha direktivat. “Jo vetëm ti jetësojmë tha gjeneralbrigade Syrja Gjoka por mbi të gjitha të marrim masa për realizimin e tyre. Këto prioritete dhe objektiva të këtij viti vazhdoi ai më tej kërkojnë kurajë, gjykim, perceptim dhe përkushtim të gjithanshëm. Ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli ka theksuar në direktivë se realizimi i saj është për të ngritur në një shkallë më të lartë dinjitetin e Forcave të Armatosura duke e renditur në lartësinë e detyrave që kërkojnë interesat e vendit dhe kjo frymë mbizotëron jo vetëm në zërtimin e tyre, por dhe në diskutimet e gjera ku u përfshinë pothuajse të gjithë drejtuesit e Brigadës Logjistike. Të gjithë sektorët dhe komandantët e reparteve, jetësimin e kësaj direktive e konsiderojnë direkt me detyrat vjetore që do të mbulojnë sipas specialitetit të tyre. Kolonel Besnik Sylaj, zëvendëskomandant i kësaj brigade theksin e vuri në drejtimit kryesor të rristrukturimit, zhvillimin e ka-

paciteteve operacionale dhe atyre mbështetëse, përsosjen e sistemit të arsimit stërvitjes infrastrukturës, modernizimi dhe rritja së efektivitetit. Ndërsa kolonel Gaspër Lala tha për objektivat dhe prioritet kryesor se kërkojnë një planifikim të detajuar për zhvillimin e objektivave të kapaciteteve. Nënkolonel Ferdinand Mersini, shef i Personelit, tha se në këto direktiva i rëndësishëm është objektivi për kryerjen e reformës ligjore dhe asaj strukturore si dhe lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut. Për personelin thelbësor mbetet dhe për këtë vit, arsimimi, trajnimi, stërvitja dhe vlerësimi në përputhje me standartet më të përparuara të NATO-s. Për Brigadën Logjistike në Direktivën e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2014 demontimi i municioneve të tepërta do të vijojë edhe gjatë vitit 2014 dhe zëvendëskomandanti i QAME tha se forcimi i masave të sigurisë në këtë proces duhet të jetë e përsosur për të shmangur aksidente apo ngjarje të jashtëzakonshme. Procesi i certifikimit të poligoneve do të vazhdojë. Ndërsa kapitenët Markelian Kodra, Altin Hazizaj, Vladimir Pica, Klodian Nurellari, Ilir Dhima, Elio Shena e Roland Hysa, që shërbejnë dhe drejtojnë grupet e asgjësimit e certifikimit të poligoneve, detyrat që shtrun kjo direktivë i konsiderojnë si plan ditor të punës së tyre. Në direktivë theksohet dhe evidencimi i materialeve dhe pajisjeve të tepërta, që do të jetë prioritet i kësaj njësie për vetë misionin që ka dhe nënkolonel Lulëzim Kameri, shef i Logjistikës së

brigadës thotë se këtë objektiv do ta realizojmë me shumë përgjegjësi dhe me vijimësi. Nënkolonel Shpëtim Doda, shefi i Zyrës së komandantit të Brigadës, bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes është fokusi kryesor për këtë vit, të vihet tek puna në grup, tek implementimi i kësaj direktive deri në detaje. Financat në këtë vit do të administrohen me shumë kujdes dhe major Sali Kuçana planizimin e konsideron shumë të rëndësishëm. Për pjesën ekonomike këshilltari ekonomik Hamdi Zaja kërkon planizim dhe ndjekje të detyrave deri në ditën e fundit të vitit. Tetare Arta Kurti ndjek ritmin e punëve të ditës dhe zbatimin e detyrave të marra nga eprori për të shkuar të gjitha detyrat në destinacionin e duhur. Por diskutimi i direktivës dhe jetësimi i saj ka vazhduar dhe në Batalionin e Transportit dhe kapiten Egert Kuka ka bërë zërtimin e tyre sipas kalendarit vjetor. Shefi i operacioneve në QAME, kapiten Lutfi Toçilla stërvitjen dhe përgatitjen profesionale e quan të rëndësishme. Zërtimi i direktivës ka filluar dhe në Rajonin e Beratit me komandant nënkolonel Agron Budlla dhe në Rajonin e Elbasanit me komandantit, nënkolonel Ediant Elezi. Një dimension të ri do të marrin dhe marrëdhëniet me publikun dhe performanca mediatike e Forcave të Armatosura. Ky dimension i ri shtrun shumë detyra dhe shefja e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak, nënkolonele Shkurte Bytyçi në Brigadën logjistike, konfirmon një frymëmarrje të re në këtë drejtim.

NJOFTIM

PËR HAPJE TË KURSIT TË 9-të TË FORCAVE SPECIALE NË BATALIONIN SPECIAL TË FORCAVE TOKËSORE

Kandidatët që do të aplikojnë për të marrë pjesë në kursin e 9-të të Forcave Speciale, të paraqiten për të dorëzuar dokumentacionin përkatës pranë Seksionit të Personelit (S1) në Batalionin e Forcave Speciale, me adresë “Zall-Herr” Tiranë, ku do të njihen me rregulloren, kriteret, procedurat e testimit, etj.

Regjistrimi për kursin e 9-të të Forcave Speciale bëhet vetëm për kandidatët ushtarakë aktivë në FA. Regjistrimi përfundon në datën 27.01.2014 ora 12.00 dhe zhvillohet pranë Seksionit të Personelit (S1) në Batalionin e Forcave Speciale. Data e zhvillimit të testeve për kandidatët do të jetë data 03-14 shkurt 2014 në ambientet e Batalionit Special në Zall-Herr, Tiranë.

• *Kriteret për regjistrimin e kandidatëve:*

1. Të jetë ushtarak aktivë në FA (Oficer, n/officer, ushtar profesionist)
2. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
3. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm në të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformatojnë pamjen.
4. Të mos jetë bartës i virusit HIV dhe Hepatit B; të mos ketë kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive.
5. Të jetë me gjatësinë trupore, mbi 175 cm.
6. Të ketë minimum 1-3 vjet ushtarak aktiv në FA.
7. Për kandidatët Oficer të ketë nivel të gjuhës angleze nivel 2/2/2 sipas STANAG 6001 ose 70 pikë ALCPT.
8. Për kandidatët N/Oficer të ketë nivel të gjuhës angleze nivel 1/2/2/1 sipas STANAG 6001 ose 60 pikë ALCPT.
9. Për kandidatët ushtarakë profesionistë të ketë nivel të gjuhës angleze nivel 1/2/2/1 sipas STANAG 6001 ose 60 pikë ALCPT.

• *Për oficerët*

- a. Të jetë nga grada N/Toger deri në Kapiten.
- b. Moshë maksimumi 27 vjeç.

• *Për n/officerët*

- a. Të jetë nga grada N/Tetar deri në Tetar.
- b. Moshë maksimum 27 vjeç.

• *Për ushtarët profesionistë*

- a. Moshë maksimum 27 vjeç.
- b. E preferueshme të kenë përfunduar kursin fillestar.

• *Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente:*

1. Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati, në të cilën të jetë shkruar arsyet e futjes në kursin special.
 2. Certifikatë origjinale për gjuhën angleze (nëse e ka) nëse s'ka do testohet në Batalionin e Forcave Speciale.
 3. Fotokopje e kartës së identitetit.
 4. Certifikatë familjare, 1 copë.
 5. Fotografi për dokument, 2 copë (4x6 dhe 9x12).
 6. Të dhënat e personelit sipas formatit ushtarak, të firmosura nga shefi i personelit të njësisë ku shërben (CV).
 7. Kopje/vërtetim nga personeli mbi praktikën disiplinore të kandidatit.
- Gjithashtu njoftohen të gjithë aplikantët të cilët kanë dorëzuar dokumentacionin përkatës për regjistrim në kursin e 9-të të Forcave Speciale, të kontaktojnë me zyrën e personelit në për të rikonfirmuar pjesëmarrjen në të kurs.

Për çdo informacion në lidhje me kriteret e pranimit dhe testimit, pikë kontakti:

Pikë kontakti 0688014344
florjan.bamkallari@aaf.mil.al
Adresa: Zall-Herr, Tiranë

BATALIONI SPECIAL I FORCAVE TOKËSORE

Përse ti duhet të jesh pjesë e batalionit të Forcave Speciale:

1. karrierë ushtarake të garantuar për personelin ushtar profesionist dhe n/officer, pasi të gjitha funksionet organike në BFS janë për n/officerë dhe pjesa më e madhe e tyre janë të gradës tetar- rreshter- kapter.
2. të ndihesh krenar për veten tënde, bëj diçka që të tjerët nuk kanë mundësi fizike dhe intelektuale ta bëjnë. motoja jonë është “më mirë të vdesim për diçka sesa të jetojmë pa bërë asgjë”.
3. trajnim dhe stërvitje e njëjtë me ato të standardeve të forcave speciale të vendeve aleate të NATO-s.
4. ti ke mundësi të kapërcesh kapacitetet e tua, ti mund të bësh më tepër për veten dhe për vendin tënd.
5. ti do të kesh mundësi të punosh me personel me përvojë të jashtëzakonshme, shumë prej të cilëve kanë nivel shumë të lartë profesional dhe do të trajnohesh në më shumë se një specialitet, pra ti mund të aftësohesh në shumë specialitete, (zhytës, anti-terror, parashutist apo alpinist).
6. ti do të trajnohesh nga instruktorët më të mirë të forcave speciale të vendit tonë por gjithashtu dhe të vendeve aleate. do të marrësh njohuri të cilat do të kesh mundësi ti vesh në përdorim kudo në jetë.

Brigada e V-të Sulmuese, kjo “Heroinë e Popullit”

Në faqet e gazetës “Ushtria” nga ky numër e në fillim do hapet një rubrikë e cila do të pasqyrojë aktivitetin e Luftës Nacional-Çlirimtare shqiptare. Kjo rubrikë hapet duke marrë shkas nga 70 vjetori i Çlirimit të Shqipërisë nga pushtimi nazi-fashist i LIIB. Materialet e sjella në këtë rubrikë do të jenë kryesisht të karakterit historik e strategjik dhe lexuesi do të ketë mundësinë që të informohet në lidhje me këto ngjarje nëpërmjet punës së historianëve ushtarakë, të cilët janë pjesë e “Shoqatës së historianëve ushtarakë” dhe të “Institutit të studimeve të historisë ushtarakë”

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj
Historian Ushtarak

Brigada V Sulmuese (Br. V S) u përrua më 20 janar 1944 në Bramyshje të Tërbaçit, rrethi Vlorë, duke pasur një efektiv prej 950 luftëtarë të rreshtuar në pesë batalione. Bërthama e saj prej dy-tre batalione partizane u krijua më 28 nëntor 1943 në fshatin Gumenicë të Vlorës. Fillimisht ajo pati dy batalione e një në organizim e sipër, në luftime me një efektiv prej 550 luftëtarë. Komandant u caktua Abaz Shehu dhe komisar Hysni Kapo. Me krijimin e saj ajo u angazhuar në luftime për të thyer Operacionin gjerman “Bergkessel” në luginën e Shushicës. U zhvilluan luftime të ashpra në Dukat e në Gjorm. Më 12 dhjetor 1943, ra heroikisht në Gjorm Abas Shehu, komandanti i saj. Për drejtimin e Br. V S në komandë, në përrimin e saj u caktuan komandant Shefqet Peçi (Heroi i Popullit), komisar Hysni Kapo (Hero i Popullit), zëvendëskomandant Dervish Hekali, zëvendëskomisar Manush Myftiu. Formimi i Br. V S përbën ngjarje me rëndësi në historinë e Luftës dhe të UNÇSH. Br. V S ka zhvilluar mjaft luftime e goditje mbi armikun, ku me të rëndësishmet kanë qenë: luftimet gjatë Mësymjes së përgjithshme armike të operacionit të Dimrit 1943-1944, në zonën e Mesaplikut-Kurvelesh-Bregdet-Salari;



luftimet për mbrojtjen e Kongresit të Përmetit; luftimet e ashpra në bashkëveprim me brigadat e tjera të rreshtuara bashkë me të në Div. I S, për thyerjen e mësymjes së përgjithshme armike të Qershorit 1944; në luginën e Tomoricës, siç janë ato të Qafës së Gjarprit e të Gurit të Prerë, të Shëmbërdhejt dhe Qafë Dardhës. Me kalimin e Div. I S në Shqipërinë e Mesme e të Veriut, Br. V S zhvilloi luftime në luginën e Shënpalit dhe në krahinën e Matit (Burrel, Macukull). Në bashkëveprim me repartet partizane të Dibrës dhe Br. IV S çliroi qytetin e Peshkopisë dhe gjithë krahinën e Dibrës. Gjatë muajt gusht theu të gjitha përpjekjet për të pushtuar qytetin e Peshkopisë. Më 3 shtator duke bashkëveprim ngushtë me forcat e Br. XVIII S, çliroi qytetin e Dibrës. Përsëri në bashkëveprim me forcat partizane të Lumës, e çliroi këtë krahinë dhe mbajti nën goditje të vazhdueshme rrugën Kukës-Prizren. Ngushtësisht bashkëveproi me forcat partizane të Tropojës dhe me batalionin partizan “Perlat Rexhepi” për të shpartalluar forcat e reaksionit në këtë zonë. Më 1 tetor së bashku

me Br. III S kaloi në Kosovë për të ndihmuar vëllezërit kosovarë dhe popujt e Jugosllavisë të çliroheshin nga robëria fashiste. Në bashkëveprim edhe me Br. I dhe IV Kosovare dhe Br. III S të UNÇSH, çlijuan pjesën perëndimore të Kosovës, si dhe qytetet Gjakovë, më 10 nëntor dhe Prizren, më 17 nëntor 1944. Gjatë qëndrimit në krahinën e Kosovës, ajo e shtoi efektivin e saj me vullnetarë kosovarë deri në 2.000 luftëtarë, krijoi dhe baterinë e artilerisë malore me 6 gryka zjarri 75/13 mm, të kapura armikut në Prizren. Më 25 nëntor ajo u rreshtua në Div. V S dhe së bashku me brigadat e tjera të këtij divizioni dhe forcat e Br. XII, të Div. XXXVII të UNÇJ zhvilloi luftime dhe çliroi krahinat e Sanxhakut dhe qytetet e tij Seniq, Priepolje e Priboj. Gjatë luftimeve të zhvilluara Br. V S i ka shkaktuar armikut mjaft të vrarë e të plagosur, si dhe kapjen e robërve. Nga radhët e saj ranë në fushën e luftës mbi 350 dëshmorë dhe midis tyre Abaz Shehu, Dervish Hekali, Kastriot Muço, Zaho Koka, Zonja Çurre, Laze Nuro Ferraj, Llambro Andoni,

Hysen Çino, Nimete Progonati, të gjithë Heronj të Popullit. Ndër kuadrot drejtues të batalioneve të saj u dalluan Mehmet Jaho, Nuri Arapi, Sali Ormeni, Kadri Hazbiu, Mehmet Ali Shehu, Zanel Hamiti, Çelo Arrza, Hajdar Aranitasi, Isak Lilaj, Rahman Përlaku (Hero i Popullit), Hito Çako (Hero i Popullit), Birbil Klosi, Delo Balili, Andrea Varfi, Ramize Gjebrea, Kadri Brahimi, Tanush Shyti etj. Brigada botonte organin e saj luftarak “Buçitja”. Ajo kreu me nder mbi 20 beteja të rëndësishme dhe dhjetëra luftime e aksione në rrugëtimin e saj. Në rrugën luftarake të saj ajo përshkroi mbi 2900 km, duke i shkaktuar armikut humbje të mëdha material si dhe të vrarë, të plagosur dhe të kapur rob. Ndër luftimet më heroike të Br. V S janë betejat e zhvilluara në Vajzë, Palasë, Vuno, Picar, Pilut, Salari, Gjorm, Gjirokastër, në roj të Kongresit të Përmetit, Qafa e Gjarpërit, Shëmbërdhenj, Tufinë, Qafë Bardhë, Guri i Prerë dhe Sulovë. Gjithashtu janë të njohura luftimet e saj edhe në Gramsh, Berat, krahina e Elbasanit, Tiranë, Mat, Peshkopi, Dibër e Madhe,



Përkujtohet 70-vjetori i krijimit të Brigadës së V-të Sulmuese

Është përkujtuar në datën 19 janar 2014, 70-vjetori i krijimit të Brigadës së V-të Sulmuese në Bramyshnje të fshatit Tërbaç, Vlorë. Krahas pjesëmarrjes së shumtë qytetare, në këtë aktivitet morën pjesë edhe deputetët Fatmir Toçi, Valentina Leskaj, Petrit Vasili, zëvendësministri i Mbrojtjes, Dritan Hila, këshilltari për mbrojtjen i Kryeministrit, Gjeneral Sandër Lleshi si dhe ish-Presidenti Alfred Moisiu e personalitete të ardhura nga Kosova pikërisht për këtë festë. Brigada e V-të Sulmuese ka qenë një nga brigadat më të rëndësishme të Luftës çlirimtare. Në



këtë eveniment që përkujton 70-vjetorin e Brigadës së V-të Sulmuese, u krijua një moment fillestar për aktivitetet kremtuese të 70-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë në LIIB. Përkujtimi i Luftës antifashiste është krenari e ligjshme për çdo shqiptar, pasi në atë Aleancë fituese Shqipëria u rendit dinito. Brigada e V-të, e cila mban emrin, “Hero i Popullit”, është tregues real i luftës heroike së kryer.

Lumë e Tropojë. Në tetor-nëntor 1944 kaloi kufirin shtetëror dhe zhvilloi luftime të ashpra kundër nazizmit në Kosovë së bashku me partizanët kosovarë. Gjatë luftimeve në Kosovë dhe në tokat e Jugosllavisë ranë në fushën e nderit 141 dëshmorë, nga këta 40 ishin luftëtarë kosovarë të rreshtuar efektiv i saj. Br. V S u bë e lavdishme dhe u vlerësua nga populli për kontributin e dhënë gjatë rrugëtimin të saj historik në përmbushjen e misionit fisnik të saj, çlirimin e tokave shqiptare nga pushtuesit e huaj. Për luftën e saj me vetëmohim dhe heroizëm të lartë kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve i është dhënë titulli “Hero i Popullit”, me këtë motivacion: “Për luftën e saj me vetëmohim dhe heroizëm të lartë kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve, për kontributin e shquar që ajo ka dhënë në çlirimin e atdheut dhe në vendosjen e pushtetit popullor. Ajo i ka përmbushur kurdoherë me trimëri të pashembullt, me besnikëri të pakufishme detyrat e mëdha luftarake e politike ndaj popullit dhe ka treguar në të njëjtën kohë një frymë të thellë të internacionalizmit, kur Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare e ngarkoi atë të shkonte tok me njësi të tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për të ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë...”. Për Br. V S është shkruar Historiku i saj, është ngritur përmendorja në vendin ku u bë inaugurimi, si dhe për mjaft nga heronjtë, dëshmorët e kuadrot e saj janë shkruar monografi të ndryshme. Në vijimësi në këto 70 vjet janë ngritur buste dhe përmendore, janë bërë piktura e tablo të ndryshme si dhe janë realizuar filma që i kushtohet kësaj njësie luftarake.

“STRIKING EAGLES 4”

Ekipi shqiptaro-amerikan MAT 4 gjatë kryerjes së detyrës në Afganistan

